



REVISTË SHKOLLORE E M.M. "ALAUDDIN" PRISHTINË



Nr. 46 / Qershor 2021

DRITA e نور القرآن KUR'ANIT

www.medreseja.com



A E DI
KUR DUHET TË QASH PËR VETEN?



O ju që keni besuar, pendohuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, në mënyrë që Zoti juaj t'i largojë prej jush të këqijat, dhe Ditën kur Allahu nuk e turpëron Pejgamberin, e së bashku me të as besimtarët, t'ju shpie në xhenete nën të cilët rrjedhin lumenj! Drita e tyre ndriçon para tyre dhe në të djathtë të tyre, e ata thonë: Zoti ynë, na e vazhdo dritën tonë, dhe na fal neve! Vërtet Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë!

(Tahrim, 8)

Përmbajtja:

- 3 FJALA E REDAKSISË
- 4 FADIL EF HASANI, DREJTORI I RI I
MEDRESESË SË MESME ALAUDDIN
- 5 MEDRESESË
- 5 KUR HODHA HAPIN...
- 6 RRUGA PËR NË SHTËPI
- 7 SË BASHKU NJË DITË TJETËR
- 7 PJESË E SHPIRTIT TIM - MEDRESEJA
ALAUDDIN
- 8 PSE E ZGJODHA MEDRESENË?
- 10 KUR DËGJONI FJALËN "FARAON",
ÇFARË JU SHKON NDËR MEND?
- 11 A E DI KUR DUHET TË QASH PËR
VETEN?
- 11 NJË PERLË PREJ SHPIRTIT PËR TY
NEFESI IM
- 12 FAKTE RRETH FESË ISLAME
- 12 NJOHURI NGA FEJA ISLAME
- 13 7 MREKULLI MATEMATIKORE NË
KURAN
- 13 E VETMJA STREHË
- 14 E BUKURA MBI MË TË BUKURAT
- 15 HAXHI 2020
- 16 LUTEM PËR TY
- 16 NUK ËSHTË DOBËSI
- 17 TË DUA PËRGJITHMONË
- 17 QETËSI SHPIRTËRORE
- 18 SFIDAT E NXËNËSIT NË KOSOVË
DHE MËNJANIMI I TYRE
- 19 NXËNËS TË SUKSESSHËM
- 28 INTERVISTË ME ANËTARË TË
SHKOLLËS "AHMET GASHI"
- 30 INTERVISTË ME ANËTARË TË
SHKOLLËS "XHEVDET DODA"
- 32 THËNIET E MATURANTËVE
- 37 IN MY MIND
- 38 FOR MY FRIEND
- 39 MY SECOND HOME
- 39 ÌNATÇI OL
- 39 WELCOME TO SOCIETY
- 40 VATËR E DITURISË
- 40 NANËS
- 40 TË LARGOHEM
- 41 AJO KISH' HESHT'
- 41 DU PAK QETËSI
- 41 DASHURIA IME PËR TY
- 42 AKTIVITETE
- 47 TË LEXOJMË MË SHUMË!
- 48 DISA KËSHILLA PARA SE TË HYSH
NË TESTIMI
- 48 KURIOZITETE
- 49 12 PYETJET MË TË BUKURA TË
BËRA NDONJËHERË
- 50 URTINA UKA 11/3
- 51 ERINA SALIHU 10/3
- 51 IMRANE ZARIQI
- 52 RINESA ZENELI 11/3

FJALA E REDAKSISË

Gjithë lavdërimi i takon Allahut të Lartësuar! Vetëm Atë e
glavdërojmë, dhe vetëm prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje!

Vitin që lamë pas ishte i mbushur me shumë ngjarje dhe fenomene të reja, e falë rëndësisë së arsimit duhet të vazhdojmë përballë çdo vështirësie edhe në këtë vit.

Si përfaqësuese e redaksisë gjatë këtij viti jam ndjerë shumë e privilegjuar për besimin e dhënë dhe mundësinë që më është ofruar, dhe gjithmonë kam qenë e gatshme t'i shërbej shkollës sime, në synime e interesa të përbashkëta e të dobishme; çdo vit që kemi kaluar me plot aktivitete të larmishme, këtë vit në shkollën tonë ato u reduktuan mirëpo nuk munguan, pra edhe pse ishin në kushte pandemie për shkak të gjendjes së shkaktuar nga Covid-19.

Mua do të më mungojë ngrohtësia që më është ofruar në këtë shkollë nga motrat, kujdesi e përkushtimi i drejtorit dhe mësime-dhënësve për të na edukuar sa më mirë, e të cilët nuk mund t'i falënderojmë mjaftueshëm për mundin, kohën dhe mundësitë që na i ofruan përgjatë këtyre viteve.

Edhe pse mënyra se si ne e zhvilluam mësimin ishte diçka krejt ndryshe, dhe nuk ishte e lehtë të pranohej edhe nga ana jonë, me ndihmën e kësaj shkolle dhe ligjërimit të mrekullueshëm të profesorëve dhe profesorehave arritëm ta përfundojmë udhëtimin tonë në Medresë.

Falënderimi i takon Allahut që na zgjodhi ne në mesin e moshatarëve tonë, që ta mësojmë fjalën e Tij dhe njëkohësisht të nisëmi drejt studimeve pas Medresesë, kudo që ne dëshirojmë!

Për fund, në emër të krejt shoqërisë në këtë shkollë, e falënderojmë përzemërsisht drejtorin dhe gjithë stafin për përkushtimin e tyre, që ne si shoqëri e kësaj shkolle të dallohemi me ngritje profesionale, morale dhe edukative!

Në mesin e kësaj shkolle gjetëm dashurinë më të pastër dhe shoqërinë më të mirë. E porosia ime për gjeneratat e ardhshme është që të jenë nxënës shembullorë, të dalluar në të gjitha aspektet, dhe mos të ndalojnë së përpjekuri për t'i realizuar ëndrrat e tyre, pasi çdo gjë është e mundur të ndodhë nëse veprohet me zgjuarsiri dhe përpikëri!

Elma Zeneli12/4

Kryeredaktore: **Hatixhe Hasani 12/4**

Redaktor: **Granit Sadiku 12/2**

Anëtarë të redaksisë:

Burhan Abdullahu 10/2

Amër Suma 10/1

Hadis Gashi 11/1,

Rijad Krasniqi 11/2,

Jon Thaçi 12/1,

Ismail Mahmuti 12/2,

Seid Arbanashi 12/3

Lektor dhe redaktor letrar: **Besnik Jaha**

Dizajni: **Bashkim Mehani**

E-mail: **redaksia15@hotmail.com**

www.medreseja.com

FADIL EF HASANI, DREJTORI I RI I MEDRESESË SË MESME ALAUDDIN

Medreseja e Mesme Alauddin këtë vit u bë me drejtorin e ri, profesorin Fadin ef. Hasani.

Fadil Hasani ka lindur më 09.02.1961, në Rzhane, komuna e Mitrovicës.

Shkollën fillore "Rifat Vidishiçi" e ka kryer në Bare, paralelja e ndarë fizike e Rzhanës, nga klasa e parë deri në klasën e pestë (1967-1972), ndërsa nga klasa e gjashtë deri në të tetën (1972-1975) e ka vazhduar po në shkollën fillore "Rifat Vidishiçi" në Bare, mirëpo në paralelen e ndarë fizike në fshatin Selac. Nga viti 1975 deri në vitin 1980 ka vazhduar shkollën e mesme në M. M. "Alauddin" në Prishtinë, ndërsa më pas ka vazhduar në Institutin e Gjuhës Arabe, "El Mustansirijah", në Bagdad, në vitet 1980-1981, për t'i vazhduar studimet në universitetin e Bagdadit, Fakulteti Filozofik, drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Arabe, në vitet 1981/82-1984/85.

Pas një kohe të gjatë si punëtor në Medresenë e Mesme Alaudin, fillimisht si edukator, në vitet 1985-1991, pastaj si profesor i gjuhës arabe, në vitet 1991-2020, profesor Fadil Hasani ka vazhduar edhe studimet pasuniversitare, për ta marrë titullin Magjister i Filologjisë Orientale – Gjuhë dhe Letërsi Arabe, në Universitetin e Tetovës, në 2020.

Aktualisht është ligjërues edhe në Fakultetin e Studimeve Islame (FSI) në Prishtinë, punë që e ka nisur që nga viti 2014.

Profesor Fadil Hasani për një kohë të gjatë ka kryer edhe shërbime me rëndësi në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, ndër të cilat:

- Anëtar i redaksisë së revistës EDUKATA ISLAME.
- Bashkëpunëtor i revistës DITURIA ISLAME.
- Bashkautor i tekstit "Gjuha arabe 3", recensent i teksteve shkollore.
- Përkthyes i dy pjesëve 3 dhe 5 të librit "Fragmente nga jeta e sahabëve" nga gjuha arabe.
- Në vitin 2008 ka nisur ushtrimin e funksionit të nënkryetarit të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, 2008-2013 dhe 2013-20015
- Kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, gusht-tetor 2013.

Tashmë profesor Fadil Hasani është zgjedhur drejtorit të Medresesë së Mesme Alauddin në Prishtinë, funksion të cilin do ta ushtrojë për katër vjetët në vazhdim (gusht 2020/2024). Jeton në Prishtinë.



MEDRESESË

Ndonjëherë të gjithë kemi nevojë për një dorë që ndihmon. Për të na ndihmuar të ngrihemi në këmbë. Ndonjëherë është e guximshme të thuash se je lodhur, ose se nuk mund të bësh asgjë më shumë. Të kërkosht ndihmë është një forcë, dhe jo një dobësi.

Të gjithë ne, në një moment të jetës kemi nevojë për dikë që të na ndihmojë të bëjmë ose të marrim diçka. E të gjitha këto unë dhe shumë mikesha i gjetëm te shkolla jonë. Te shtëpia jonë: te Medreseja jonë!

Luljeta Klinaku ,12/4

KUR HODHA HAPIN...

Kur hodha hapin te ti, e dashur Medrese, një shkëndijë plot dritë e zjarr u ndez brenda meje. S'e kuptova ç'po ndodhte. Vend i panjohur e me njerëz të panjohur. Papritur m'u bë shtëpi e mbushur me një familje të madhe, ku mbizotëronte vetëm dashuria për hir të Zotit dhe Fjalë së Tij. Sikur çdo gjë aty po mbante vetëm bardhësi e dije të pakufishme; një vend i ngushtë e me shpirt të gjerë, me staf që çdo herë gjen ngrohtësi shpirtërore për secilin.

Kjo është esenca e kohës sime. Minutat në ty ishin më të vlefshme se çdo gjë tjetër. Periudha që ndava në ty ishin vitet që dallova nga 18 vjet të jetës sime. Netët e gjata nëpër korridoret e tua të ngushta mbusheshin çdo herë plot hare. Sikur edhe sot këto mure po bëjnë zhurmën që dikur e bënim ne nga të qeshurat deri në orët e hershme të mëngjesit. Je një hap thesari që rrugët e mia i mbush përplot sukses. Plot sukses që është ndërtuar me dashuri dhe respekt, që është ndërtuar me frymë paqeje dhe që përsos në atë që ishte nisur.

E ku ka më mirë se ti, o e dashura Medrese! E ku të gjej prapë si ti, o dritë e shpirtit dhe aromë e Xhenetit. Mos mbaro, të lutem! Na mbaj edhe pak! Ndali akrepat e orës, e mos na lër të ikim! Na mbaj shumë fort, ashtu siç bërë çdo herë kur ne ishim të mërzitur!

Ti je krenaria ime, o det i pashterur. Je kujtimi im, vetë jeta ime. Je ndërtuesja e themeleve të shpirtit tim, që e mbushë përplot me dije e paqe. Nga ti nuk dua të ndahem kurrë. Kam frikë të jem larg teje. Ah sikur të kthehej koha pas, e t'i përjetojta prapë çastet e mira që kalova te ti! Sikur mos të mbaronin asnjëherë!

Driton Sahiti, 12/3

RRUGA PËR NË SHTËPI

Njeriu, për të pasur sukses, duhet të ketë vizion, dhe gjithmonë duhet të shikojë larg e më larg. Këtë largësi nuk duhet vetëm ta shikojë, por duhet edhe ta ndjekë, deri sa ta arrijë synimin. Rruga drejt arritjes së qëllimit ka dhembje e mundim, e kjo dhembje e mundim ndalet kur vjen momenti që të kthehesh përsëri aty ku filloi gjithçka: në vendlindjen tënde.

Ende i kujtoj dhe i përjetoj ende ato momente kur kthehesha në shtëpi. Pavarësisht sa largësi ishte, dhe sa lodhje kisha, ndaleshin kur mendoja dhe thosha se po shkoja në shtëpi; dhe ndihesha njeriu më i lumtur në botë. Mund ta parafytyroj autobusin që të dielave nuk më pëlqente fare, kurse të premtëve ishte gjëja më e preferuar. Ajo rrugë që më dukej e pafund të dielave, të premtëve dukej rruga më e shkurtër.

Kjo rrugë më përcjell dhe sot. Shumë shpejt filloje java, dhe po kështu shpejt mbaronte. Dita e diel ishte ajo ditë që më shkonte me mundim. Dita e diel kalonte duke i bërë rrobat gati dhe duke i futur ashtu paksa me vështirësi në çantë. Dhe nisesha për në shkollë, pa dyshim se me mërzi, sepse nuk do të isha në shtëpi dhe me familjarët për pesë ditët e ardhshme. Udhëtoja me ata autobusët e lodhshëm e të mundimshëm; rruga më dukej e gjatë një mijë vjet. Dhe pa dyshim se gjatë asaj kohe mërzitesha për shtëpinë time. Derisa mbërrija në shkollë, më duhej t'i ndërroja dy autobusë, dhe lodhesha shumë nga rrugëtimi katërorësh.

Me të mbërritur ne shkollë, i njoftoja familjarët se kisha mbërritur mirë dhe se isha mirë po ashtu. Dhe kështu e kaloja ditën e diel. Fillonte java, dhe si çdo javë kalonte me entuziazëm dhe shumë gjëra të reja që ndodhnin me e pa planifikim. Shumë shpejtë vinte edhe dita e premtë, ditë që njëherazi ishte dita më e dashur e gjithë nxënësve. Me ta falur namazin e xhumasë, ndërroja uniformën dhe merrja çantën që e kisha gati që nga dita e enjte, dhe nisesha për në shtëpi.

Tani gjërat ishin krejtësisht të kundërta me ditën e diel. Autobusët e lodhshëm e të mundimshëm tani ishin autobusët më të mirë dhe më të shpejtë në botë. Sepse ata na dërgonin në vendin më të mirë në botë: në shtëpi.

Rruga e gjatë tani për mua shkurtohej, dhe tani pikëllimi që kisha të dielave kthehej në gëzim. Edhe pse kaloja katër orë rrugë për të shkuar në shkollë, kur kthehesha për shtëpi, ditëve të premtë, më dukej gjithmonë udhëtimi më i mirë i bërë ndonjëherë, si dhe, çuditërisht, udhëtimi nuk zgjaste tamam katër orë.

Dhe tani, në këtë kohë dhe në të ardhmen, shpresoj se gjithmonë do të më përcjellin këto rrugë, për shkak se këto rrugë më japin kujtime të bukura, dhe po këto rrugë më drejtojnë kah e ardhmja ime: shtëpia e familja ime.

Enis Fejzullahu, 12/3

SË BASHKU NJË DITË TJETËR

Kur shkruaj për ty, mendohem gjatë e gjatë, sepse për vendet e veçanta duhet të zgjedhësh fjalë të veçanta. Filloj e i shkruaj ca fjalë, e pastaj edhe ca rreshta. Pastaj ndodh që edhe nga sytë fillojnë të më pikojnë lot, duke i kujtuar momentet e lumtura e të paharrueshme të kaluara në gjirin tënd. Pastaj për një moment provoj t'ia rifilloj shkrimit, mirëpo nuk kam fuqi. Mundohem t'i mbledh të gjitha forcat, por s'mundem... s'mundem. Menjëherë më shfaqen në mendje se edhe ca muaj e ca ditë që unë të largohem nga ky vend. Sikurse ata që u larguan para nesh. Shumë pyetje më sillen në mendje. A thua a do ta përballoj këtë ndarje?! A do të më thahen ndonjëherë sytë, apo do të qëndrojnë gjithmonë të njomë nga malli për ty?! Kështu e paska jeta: çdo fillim e paska edhe një mbarim.

Ashtu siç e filluam, me emrin e Allahut, ashtu edhe po e përfundojmë. E gjitha çfarë bëj, e edhe faktikisht gjëja e vetme çfarë mund të bëj, është një dua. E ajo dua është: "O Allah, na bashko në Xhenet!" Amin!

Ismail Mahmuti, 12/2

PJESË E SHPIRTIT TIM - MEDRESEJA ALAUDDIN

Në rrugët ku nuk kishte shpresë, më dole përpara ti, o Medrese. Më dhe dashuri, më dhe lumturi, më bëre të kuptoj se jeta paska vlerë.

Nuk e kuptoj se si në ty ecën koha kaq shpejt, se si ecën vitet, e tash po qaj për fundin... Po qaj..., lotët po më rrjedhin vetvetiu, e zemra po më pëlçet kur po e mendoj se në ty më s'do të jem. Tash e kuptoj se gjërat e mira na duken se nuk zgjasin shumë. Kjo është pikërisht ajo; e ndiejmë e futemi në to me tërë qenien tonë, dhe mendojmë se do të zgjasin përgjithmonë. Dhe ja që asgjë nuk është e përgjeshme, dhe asnjë fund nuk është i lumtur.

E dashur Medrese, ti që fal dijen e universit, që jep dashurinë e një nëne, që jep sigurinë e një babai dhe që jep mbështetjen e një motre! Në ty i kalova vitet më të ëmbla; nëse ndalem dhe e mendoj, më duket se as gjysmë viti nuk isha aty!

Mirësia e Allahut është e pafundme, e këtë gjë e kuptova pikërisht në ty. Ti m'i bëre shoqet-motra e profesorët prindër; e buka jote u bë buka e shtëpisë sime.

Do të të mbaj gjithmonë në zemrën time, si kujtimin më të bukur të jetës sime dhe si pranverë të shpirtit tim. Do të të kujtoj gjithmonë, sepse ti bëre vend në zemrën time. Ti më mësove se edhe në momentet më të vështira duhet qëndruar e buzëqeshur; edhe në situatat më të tensionuare duhet të qëndrosh e qetë, se qetësia e zemrës është shpëtimi i shpirtit.

Kur i shikoj fotografitë, sytë më mbushen me lot. Kaq kujtime të bukura kam lënë pas!

Kaq të panjohura më presin para!

Zylfije Zeka, 12/4

PSE E ZGJODHA MEDRESENË?

E zgjedha Medresenë për shumë arsye; e si mos ta bëja?!

Si mos të vija në vendin ku më së miri gërshetohen feja dhe atdhedashuria.

Medreseja është vendi ku mbushet çdo boshllëk. Kërkova edhe gjetiu, por nuk gjeta vend më të shenjtë se ky; këtu mësohet fjala e Allahut, xh.sh., si dhe historitë e njerëzve më të mirë që ekzistuan ndonjëherë mbi sipërfaqen e tokës.

Haris Hoxha, 10/2

Medresenë e zgjedha sepse ka shumë precizitet, ka staf shumë profesional, si dhe ndihmon në formimin e personaliteti të mirëfilltë, pastaj i përgatit nxënësit si në aspektin edukativ ashtu edhe në atë arsimor, dhe kjo sigurisht se është për t'u vlerësuar.

Medreseja është vend me plot ngrohtësi. Vend ku e gjen familjen e dytë, me mësimdhënësit që na këshillojnë dhe na shohin si fëmijët e tyre.

E falënderoj Allahun e Madhëruar që më nderoi duke më bërë pjesë të kësaj shkolle, dhe e lus të na dhurojë sukses dhe të na bëjë prej robërve të Tij të dalluar!

Anisa Dibrani, 10/3

Për të arritur synimet në jetë, duhet ta zgjedhësh rrugën e duhur. Medreseja duhej të jetë pjesë e rrugës drejt suksesit tim! Në një shkollë ku edukata dhe morali janë primare, aty është e pamundur që mos të synoj të shkoj. Medreseja do të jetë krenaria ime, dhe unë do të jem krenaria e saj!

Subejla Franca, 10/3

Të marrësh vendime që lidhen me të ardhmen tënde është me të vërtetë e vështirë. Duket që je në një "luftë" me vetveten, sepse është koha të zgjedhësh dhe ta përcaktosh atë që do.

Viti i kaluar ishte koha që unë të vendosi se çfarë dua në të vërtetë, dhe të vazhdoj për tre vjet në vazhdim. Unë zgjedha, dhe ja ku jam.

Në fakt, ishte dhe do mbetet ndër vendimet më të mira që kam marrë dhe do të marr në jetë. Medreseja është më shumë se shkollë. Është ngushëllimi kur mund të jesh e mërzitur, mbështetja që mund të të duhet, një fillim i mbarë i ëndrrave që do t'i realizosh, si dhe shumë herë edhe arsyeja e gëzimit dhe e lumturisë që synon ta arrish.

Erdhëm si të reja, vitin e kaluar, mirëpo me ngrohtësinë që u pritëm na u duk që njiheshim prej vitesh. Edhe pse me maskë dhe distancë, ishte qëllimi dhe zemra që na bashkonte. Ishin këshillat e mësimdhënësve që na bënë ta shihnim jetën në një këndvështrim më ndryshe.

Veçantia më e madhe është se ne mësojmë për Fjalën e Allahut, xh. sh. Një ajet i vetëm i Kuranit famëlartë mund të bëhet shkak të ndryshojë jeta jonë. Çdo vajze ia sugjeroj që mos të mendojë as dy herë, mirëpo të vijë në një shkollë si Medreseja. Mos ta ndalim hapin kurrë, sepse bashkë do t'ia dalim! Ne e kemi vendin aty ku duam. Aty ku ëndërrojmë dhe aty ku punojmë fort!

Imrane Zariqi, 10/4

MË TREGONI SI...

Si kanë fjetur ata?

Si fjeti Muadh bin Xhebeli atë natë kur i Dërguari, a.s., i tha: "Pasha Allahun, o Muadh, unë të dua."?

Si fjeti Abdullah bin Uvejsi, kur i Dashuri, a.s., ia dhuroi atij shkopin, dhe i tha: "Me këtë do të të njoh në Xhenet."?

Si fjeti atë natë Bilali, kur i Dashuri, a.s., i tha: "Unë i dëgjoj nallat tua në Xhenet."?

Si fjeti Hadixheja atë natë, pasi i Dashuri, a.s., i tha: "Xhibrili po të dërgon selam prej Allahut."?

Si fjeti Ebu Bekri atë natë, kur i zbriti Xhibrili të Dërguarit, a.s., dhe i tha se: "Allahu i dërgon selam shokut tënd, dhe i thotë: "Unë jam i kënaqur me të, e a është ai i kënaqur me Mua?"?

Si fjeti Ubej bin Kabi atë natë, pasi Muhamedi, a.s., i tha: "Allahu më urdhëroi të të lexoj "diçka nga Kurani."? Ubeji i tha: "A më përmendi Allahu me emër?" - I Dërguari, a.s., i tha: "Po.". E ai fillon të qajë pa u ndalur.

Si fjetën ata? Më tregoni, si...? E si jetuan pas asaj dite?

Njeriu habitet shumë, e sikur mendja do të luajë e zemra të ndalet së rrahuri duke pyetur për ata... O Allah, ashtu siç dridhen zemrat nga këto përgëzime, na përgëzo në dynja me gëzim që i mbush zemrat, me rehati që i qetëson gjokset, e në ahiret na përgëzo me Firdeusin e lartë në shoqëri me të Dërguarin, a.s.! Amin!

Argjenda Sfishta, 12/4

FEMRA-KRIJESA MË E FORTË

Shumë njerëz më pyesin se si mund të jesh kaq e fortë pas gjithë atyre gjërave që ke kaluar. Huh, normalisht se kjo pyetje më është bërë shpesh dhe prej atyre personave që ishin pranë meje dhe kanë parë gjithë çfarë kam kaluar.

Të gjithë më shohin të buzëqeshur, mirëpo nuk e dinë të vërtetën e asaj buzëqeshjeje. Jo, sepse unë qesh fals. E forca që kam më bën të reflektoj pozitivitet.

Unë jetoj në një kopsht, e rruga ime është e shtruar me trëndafila; duket gjë e bukur, por në të vërtetë trëndafilat kanë plot gjemba. Në këmbët e mia nuk gjenden këpucë. Dhembja që ndiej nga ato gjemba nuk krahasohet me zhgënjimin që përjetova, e gabimi është imi që i lash të gjithë të ishin pjesë imja e të bëheshin pjesë e kujtimeve të mia, dhe kështu të linin gjurmë tek unë.

E dini çdo të thotë të japësh çdo gjë që t'i shohësh të lumtur ata që ke pranë vetes, por kjo mos t'ju mjaftojë. Thjesht, të largohen, dhe kjo të jetë sepse "ti s'munde t'i lumturoje".

E vështirë, a po?

Ta përjetosh është më e rëndë sesa ta thuash. Nuk po flas për ulje dhe ngritje në jetë, e që janë pjesë e çdo personi. Po flas për lëndimin e një zemre, dhe për fuqinë që gjendet brenda një femre.

Kjo forcë, pas gjithë atyre gjërave, prapë ngrihet në këmbë dhe thotë buzëqeshu, sepse kjo je ti! Mësohu të reflektosh ndryshe, dhe të bëhesh arsye që të tjerët të marrin forcë nga guximi yt! Buzëqeshja është ajo që i lumturon ata që të duan, dhe ajo i lëndon ata që të rrëzuan.

Tregoju të gjithëve se femra është një nga krijesat më të forta!

Erbolina Kasumi, 12/4

KUR DËGJONI FJALËN “FARAON”, ÇFARË JU SHKON NDËR MEND?

Shumica e njerëzve e mendojnë ai “sundimtari suprem”. Kjo është e saktë, por jo çdoherë kjo fjalë i dedikohet “sundimtarit suprem.” Historia e Egjiptit të lashtë është e ndarë në periudha të ndryshme, dhe fjala “faraon” ka kuptime të ndryshme, duke u bazuar në periudhat e historisë së Egjiptit. Si kronologji, fjala “faraon” filloi të përdoret si titull për “sundimtarin suprem” shumë vonë, diku në periudhën e quajtur “New Kingdom”, e para kësaj periudhe kjo fjalë kishte kuptimin e “shtëpisë së madhe”, dhe i referohej “pallatit mbretëror.”

Enciklopedia Britannica thotë: “Faraon, me prejardhje të pallatit mbretëror në Egjipt. Fjala filloi të përdorej (erdhi në përdorim) në periudhën “New Kingdom”.

Sikur Bibla, ashtu edhe Kurani flet për pejgamberët Jusuf, a.s., dhe Musa, a.s. Që të dy këta ishin në Egjipt. Jusufi, a.s., sipas dijetarëve, ka jetuar në periudhën “Middle Kingdom”, ose në periudhën “Second Intermediate”, shumë kohë përpara se fjala “faraon” të i dedikohej “sundimtarit suprem”. Në historinë e Jusufit, a.s., që tregohet në Kuran, fjala “mbret” i referohet sundimtarit suprem, pra, sundimtarit të Egjiptit, dhe në Kuran asnjëherë nuk përmendet fjala “faraon” për të përshkruar sundimtarin në kohën e Jusufit, a.s.

Musai, a.s., sipas dijetarëve, ka jetuar në periudhën “New Kingdom”. Në historinë e Musait, a.s., në Kuran fjala “faraon” i referohet “sundimtarit suprem” të Egjiptit, dhe asnjëherë nuk është përmendur fjala “mbret.” Kështu që, mund ta shohim se Kurani është i saktë dhe preciz në përdorimin e gjuhës dhe fjalëve në përshkrimin e udhëheqësit të Egjiptit nëpër periudha të ndryshme të historisë. Të gjitha të dhënat që ishin për ta njohur Egjiptin deri vonë ishin të bazuara në tregimet e Biblës. Të pretendohet se Kurani ka kopjuar Biblën, derisa ajo e përdor fjalën “faraon” për t’iu referuar sundimtarit të Egjiptit në historinë e Jusufit, a.s., epo kjo gjë është historikisht e pasaktë, siç edhe e sqaruam nga informacioni i enciklopedisë “Britannica”. Kjo shumë lehtë mund të kuptohet edhe nga Kurani, sepse ky i fundit nuk ka kopjuar nga Bibla, përkundrazi vërehet shumë qartë se Kurani vetëm sa e përmirëson Biblën.

Ergin Kosumi, 12/3



A E DI KUR DUHET TË QASH PËR VETEN?

Kur e sheh një të keqe dhe nuk e largon, kur e sheh një të mirë dhe e mohon, qaj për veten!

Kur namazi yt shndërrohet nga adhurimi në traditë dhe nga rehatia në vështirësi, qaj për veten!

Kur e sheh veten se gjynahet i pranon dhe i do, qaj për veten!

Kur nuk gjen ëmbëlsi në adhurim dhe kënaqësi në nënshtrime, qaj për veten!

Kur mbushesh me brenga dhe mërzi, dhe ti e ke në dorë pjesën e tretë të natës, qaj për veten!

Kur e kalon kohën në atë që nuk të bën dobi, dhe ti e di se do të jepesh llogari, qaj për veten!

Kur syri të loton nga një film, dhe nuk ndikohesh kur e dëgjon Kuranin, qaj për veten!

Kur fillon të vraposh pas dynjasë, dhe nuk kalon kohë në adhurime, qaj për veten!

Blerona Qerimi, 11/3

NJË PERLË PREJ SHPIRTIT PËR TY NEFESI IM

Për ty, o nefes, që je ngarkuar me barrën më të rëndë nga gjithë krijesat.

Për ty sot do t'i thur vargjet më të bukura, e do ta ngre mundin tënd në vlerat më të larta mbiqenësore, për t'i dhënë frymë sakrificës tënde.

Për ty sot, do ta ëmbëlsoj universin, e të kripurën mbi ty do ta asgjësoj.

Do t'i jap shpresë e vullnet, dhe do ta bëj trëndafilin më të bukur në mes të verës.

Do ta largoj acarin dhe të ftohtin e dimrit mbi ty.

Do të stolisem me citatet më të bukura, dhe do të bëj poezi të mbrëmjes së heshtur.

Tash dua edhe të kërkoj llogari...

E bukura gjendet kudo dhe kurdoherë; më thuaj, vallë, e ke kërkuar ndonjëherë kur thua se jeta është e mërzitshme?!

Sa herë je munduar të vësh pikëpyetjen në zemrën tënde, dhe të thuash "u mundova"?

Kur jeta të rrëzoi, pse lejove që gjunjët tu ta prekin tokën e të quhesh "i gjunjëzuar"?

Kur të tjerët prisnin të të shihnin të dorëzuar plotësisht, pse nuk i zhgënjeve të shihnin fitimtarin?

Mos më thuaj se pret momentin e duhur! Atë e krijon vetëm ti!

O nefesi im, o gjallëria ime, dua të të shoh mbi malet.

M'i plotëso dëshirat e mia, dhe bëj që ëndrra ime të bëhet realitet!

O nefesi im, mos më dëshpëro!

Ngrihu, puno, dhe mos u nënshtro e mos bëj të nënshtrohen!

O nefesi im, bëhu emri im! Bëhu...

Bëhu lapidari i luftës dhe i paqes, dhe bëj që zemra ime ngushëllim të vetëm të të ketë vetëm ty!

Zylfije Zeka, 12/4

FAKTE RRETH FESË ISLAME

•Islam nga arabishtja do të thotë “Paqe, siguri dhe dorëzim të Zotit”.

•Dijetarët myslimanë, Ibën Rushdi dhe Ibën Sinai ishin të parët që ruajtën veprat e Aristotelit, idetë e të cilit sunduan botët katolike dhe myslimane.

•Shpikjet që erdhën nga bota islame përfshijnë zbulimin e acidit citrik, arkitekturën arabike, minaret, kitarat, nargjiletë, kafenë etj.

•Shumë dijetarë arabë kanë marrë pjesë në zhvillimin e punëve antike greke, si në mjekësi ashtu dhe në filozofi.

•Bota islame prodhoi farmacistët e parë të specializuar e të trajnuar, të cilët krijojnë ilaçet e tyre dhe punonin me fizikanë.

•Algjebra, e njohur nga bota arabe si “al-jabr”, e kishte origjinën në botën islame.

•Po që se nuk do të ishte Islami, nuk do të pinim kafe në Starbucks. Kafeja është vetëm një nga shpikjet e shumta që erdhën nga bota islame. Shpikjet islame përfshijnë edhe banda marshimi, algjebër, spitale mësimore dhe furçë dhëmbësh.

•Farmacistët e parë të aftë dhe të trajnuar posaçërisht erdhën nga bota islame. Ata bënë ilaçet e tyre dhe bashkëpunuan ngushtë me mjekët.

Minire Rrahimi, 12/4

NJOHURI NGA FEJA ISLAME:

•Israja dhe Miraxhi kanë ndodhur dy vjet para hixhretit.

• Myslmanët katapultën e parë e kanë zënë në betejën e Hajberit.

• Llogaritjen e kohës sipas kalendarit lunar e ka aplikuar kalifi Omer bin Hatabi, r.a.

• Personit që është duke fjetur, derisa të zgjohet, fëmijës derisa të hyjë në moshën madhore, si dhe të çmendurit derisa mos të shërohet, nuk iu shkruhen veprat.

•Më mirë është për njeriun të ulet në zjarr dhe t'i digjen rrobat, sesa të ulet mbi varr.

• Mekruh (punë e papëlqyeshme) është të flesh në mes kohës së namazit të akshamit dhe të jasisë.

• E papëlqyeshme është të thuash ndihem keq; duhet thënë nuk ndihem mirë.

• Fyerja e një myslimani është mëkat, ndërsa vrasja e tij është kufr (mosbesim).

• Duhet përkujtuar njerëzve që në momentet e vdekjes të thonë: LA ILAHE ILALLAH.

Hajrije Berisha, 12/4

7 MREKULLI MATEMATIKORE NË KURAN

1. Fjala Hënë në Kuran është e përmendur 27 herë.
Koha që kalon Hëna për të bërë një rrotullim rreth Tokës është 27 ditë.
2. Fjala “Tokë” në Kuran përmendet 13 herë.
Fjala “det” përmendet 32 herë. Nëse i mbledhim këta dy numra, rezultati është 45. Nëse e shohim me përqindje: numri sa herë që përmendet emri “Tokë”, pra numri 13 është 29% e numrit 45. Po ashtu numri se sa herë përmendet fjala “det”, pra numri 32 është 71% e numrit 45.
Pas zhvillimit të shkencës është vërtetuar se 29% e planetit Tokë është e mbuluar me tokë-dhe, dhe 71% e tij është e mbuluar me ujë.
3. Fjala “ditë” në Kuran është e përmendur 365 herë.
Toka kalon 365 ditë për një lëvizje rreth Diellit.
4. Fjala “mashkull” dhe fjala “femër” përmenden 23 herë në Kuran. Kjo është interesante, sepse trupi i njeriut i ka 46 kromosome.
5. Fjala “hadid” (hekur) si e vetme përmendet 26 here në Kuran, e numri atomik i hekurit është 26.
6. Kaptina e 16-të quhet Kaptina e Bletës (Sureja En Nahël). Kjo është shumë interesante sepse numri i kromosomeve të bletës mashkull është 16.
7. Kurani ka 114 kaptina, e kaptina në mes të Kuranit është e 57-ta, “El Hadid”, që është kaptina e hekurit. Ne shekullin e kaluar është zbuluar se mesi i Tokës, pra bërthama e saj, është e përberë nga hekuri.

Enis Fejzullahu, 12/3

E VETMJA STREHË

Gjersa zemra ime pretendon largësitë, pyes veten se ç'është me mua që gjendem ende këtu?! Që s'mund të lëviz nga vendi?! Që kam ngecur kështu?!

Sikur gjendem në një vend ku qetësia e tij dëgjohet më shumë se zëri im! Sikur ndodhem në mes të oqeanit, dhe valët nuk ndalojnë së godituri!

Në fakt, nuk e di fare se ku jam. E di vetëm se ku dua të jem.

Sikur kam humbur brenda vetes, brenda mendimeve të mia, dhe mbase këto mendime m'i kanë lidhur këmbët. Qëllimet e mia më akuzojnë për dobësi, mirëpo ato ende nuk kanë kaluar në sfondin tim flakëruar.

Më ngjan sikur rrezet e diellit nuk iu mjaftojnë luleve brenda kopshtit tim, dhe ato kanë zënë të thahen! Sikur shiu nuk freskon më shpirtin tim! Sikur era e Tokës nuk më ngop më!

Në këtë botë vetëm Ai ma ngroh shpirtin. Ai është shpresa ime. Ai është krijuesi im. Edhe nëse ndodh të marrë ndonjë rrugë, prapë kthehem në hapat e njëjtë: drejt Zotit tim. Te streha ime e vetme, e pa të cilën strehë, njëmend, nuk do ta kisha gjetur veten.

Adonita Arifi, 11/3



E BUKURA MBI MË TË BUKURAT

Isha ulur. E mora penën dhe fillova të shkruaj... Po si të shkruaj?! Me cilat fjalë të shkruaj, vallë?! Me fjalët e lotëve në flet, apo me fjalët e penës?! Sidoqoftë, fillova të shkruaj, për ty, më e bukura ime. Malli i zemrës sime. Ëndrra e parealizuar, dhe lutja më e bukur e shpirtit tim.

Fillova të shkruaj për ty...

Ty, që bukuria jote edhe fjalëve më të bukura ua mund...

Ty, që zemrat për ty kanë mall...

Ty, që edhe poetët më të mirë në botë nuk ditën të të përshkruajnë...

Ty, vendit më të dashur në zemrën e më të dashurit tim...

E bukura ime... Ah ai malli i zjarhtë i zemrës sime! Ata lotët e mi për ty. Ajo dëshira e madhe për takimin me ty... Ty fjalët nuk të përshkruajnë dot.

Ah, më e bukura mbi më të bukurat! Sikur edhe unë të të shihja qoftë edhe për pak çaste! Sikur në tokën tënde ta vendosja kokën time, qoftë edhe vetëm për një sexhde të vetme! Sikur edhe këmbët e mia të ecnin mbi ty!

Ah sa të bekuar janë ata që ty të panë!

Ah sa të bekuara janë këmbët që rreth teje tavaf bënë, po ata sy që ty të panë; ah sa të bekuar janë...

Ta kesh të ditur, o më e bukura ime, se edhe pse kurrë s'të pashë, ta dish se zemra ime qysh moti është aty, pranë teje! Aty ku kishin shkelur edhe këmbët e më të dashurit (s.a.w.s). Aty ku sytë e tij të bekuar të kanë parë ty. Aty..., në vendin më të dashur për të...


O malli i pashuar i shpirtit dhe i zemrës sime! Të dua, edhe pse mundësinë për të qenë te ti s'e pata kurrë. Të dua dhe do të dua deri në frymën e fundit, kibla ime, sepse ty të deshi më i dashuri im (s.a.w.s)...

Ah, e dashura e zemrës sime, kam mall për ty si për asgjë tjetër. Mall që zemrën ma djeg dhe shpirtin ma rëndon.

Mall të madh kam... Unë e di se një ditë do të takohemi, në dashtë Allahu, sepse Ai kurrë nuk i kthen mbrapsht duart që ngrihen vetëm në drejtim të Tij. Vetëm kah Ai. Vetëm për të.

Zemra të do, edhe pse syri asnjëherë s'të ka parë, e shpirti ka mall mu sikur të të kishte parë gjithë jetën.

Arjeta Jashari, 11/4



HAXHI 2020

Normalisht, mbi 2 milionë persona marrin pjesë për do vit në haxh. Këtë vit vetëm rreth një mijë adhurues janë në pelegrinazhin vjetor, pasi autoritetet saudite vendosën kontroll të rreptë të turmës dhe masa higjienike për shkak të frikës nga pandemia.

Besimtarët myslimanë vëzhguan ritualet e para të një haxhi historik një ditë të mërkure, me rreth një mijë pelegrinë që i përmbaheshin “fluskave të sigurisë” dhe masave të distancës sociale nga frika e koronavirusit.



LUTEM PËR TY

A je larg?! Më thuaj, do të të shoh prapë? Erën tënde prej lulesh e ëmbëlsirash, a do ta nuhas? Duart tua të ngrohta, a do të ma përkëdhelin kokën edhe një herë? Më thuaj, a do të të shoh prapë?

E nëse po, a do të mësohem ndonjëherë të pres? A do të kem forcën të pres pa të parë e pa të përqafuar? A do të mund të ulem në vendin tënd, e lotët mos të më rrjedhin rrëke në fytyrën time, e cila s'ka parë diell prej kur ike?

Ndihem bosh duke të të parë vetëm në fotografi. Ndihem bosh edhe vetëm nga mendimi për një jete pa ty.

Në kujtimet e mia ti je më i bukuri kujtim. Je ende i freskët. Mos u largo kurrë sa të të mbulojë pluhuri i harresës! Mos ik edhe nga aty! Të lutem! Më lër të të shoh pak, qoftë edhe në ëndrra e kujtime!

Lutem që fjalët dhe këshillat tua të jenë melodia që do të tingëllojë në veshin tim gjatë tërë jetës! Gjatë tërë kësaj jete të shkurtë... të gjatë pa ty! Pa ty, gjyshi im i dashur!

Hafsa Dërmaku, 12/5

NUK ËSHTË DOBËSI

Dhembjet që ta kanë sulmuar shpirtin, shpërlaji me lot! Lëre lotin tënd ta vazhdojë rrugën nga sytë e tu kristal nëpër faqet e tua përrallore! Lëri lotët të t'i lehtësojnë brengat që me zor se i duron shpirti! Loti nuk është dobësi. As zemra nuk është e detyruar të përballojë diçka të hidhur. Boll i fshehe ndjenjat pas asaj maske të buzëqeshur! Nga gjuhët e rënkimeve shpirtërore është edhe të qash. Shpërlaji rënkimet tua në lot, sepse edhe ti ke vlerë! Sepse edhe ti ke ndjenja! Një gotë mbushet deri diku me ujë, mirëpo pastaj derdhet. Tërbimi i qenies tënde mos të jetë rezultat i dhimbjeve të vragave, të cilat koha i ka gdhendur në zemrën tënde! Mos u bëj si gota që derdhet pa pushim! Zëvendësoje ndjenjën tënde të mjerueshme me një kurim të plotë shpirtëror! Kuroje zemrën nga të këqijat që e kanë sulmuar! Loti është dëlirësi dhe qetësi e brendësisë. Qaj në heshtje... me dënësë... si të duash! Mos harro se pas të qarës edhe buzëqeshja ka më shumë kuptim!

Rumejsa Raçi, 10/3

TË DUA PËRGJITHMONË

A e di se çka është përjetësia?! Paj, s'është se e kam provuar edhe unë, dhe nuk është se do të jetoj përgjithmonë e ta provoj. Ama unë di të shpresoj. Unë di të besoj në atë që nuk shihet. Unë di t'i besoj dashurisë sime. Kësaj ndjenje që ushqehet çdo ditë duke parë fytyrën tënde engjëlllore.

A është për secilin përjetësia?! Paj, as këtë s'është se e kam provuar, ama e di që nuk ndihem njësoj për të gjithë, dhe nuk më mbushet shpirti me energji e çiltërsi kur flas me të tjerët. As lotët nuk është se m'i fshin çdokush. As prehri i tyre nuk është vendrrëfimi i problemeve të botës së jashtme, këtij koncepti nga i cili ti u mundove të më ruash gjithmonë me forcat e tua të veçanta.

A do të ndahem prej teje?! Ndoshta një ditë! Ndoshta për ca kohë! Ama jo se do të të harroj. Ndoshta kjo qenka përjetësia! Ta dish se nuk do ta kesh dikë në jetën tënde çdoherë, dhe të jesh i sigurt se do ta duash përherë, deri në përjetësi. Të dua përgjithmonë, Nënë! Jo vetëm një ditë, dhe jo vetëm në të keqe. Të dua përgjithmonë!

Hafsa Dërmaku, 12/5

QETËSI SHPIRTËRORE

Duhet t'ia lësh natës yjet, se janë miqtë e saj bujarë që sodisin errësirën dhe s'e lënë të duket e gjatë. Qielit, duhet t'ia lësh yjet, se janë bijtë e tij, e pa ta duket i zbrazët dhe e humb hijeshinë.

Natës duhet t'ia lësh triumfin. Le të më pushtojë me heshtjen e saj, dhe le të m'i rikthejë kujtimet për të cilat digjem flakë!

Dhe kështu, po sikur në këtë qiell, edhe në shpirtat tanë shëmbëllojnë yje. Që nga miqtë kur të ndahemi me lot plot mall qajmë.

Miqve ua lëmë kujtimet. Sikur yjeve qiellin.

Dhe sikur më kurrë s'do të shihemi. Po në zemër ua bëjmë vendin. Po sikurse yjeve në qiell.

Saniye Demaj, 12/5



SFIDAT E NXËNËSIT NË KOSOVË DHE MËNJANIMI I TYRE

Në literaturën e shkencës së Sociologjisë vërejmë se arsimi është një ndër faktorët më vendimtar në zhvillimin apo dështimin e një shoqërie. Përveç kësaj, vlen të theksohet se edhe feja është ajo që e nge lart konceptin e arsimimit apo të leximit.

Bashkë jemi dëshmitarë të gjendjes arsimore në tërë albanosferën, me theks të veçantë në vendin tonë. Në dhjetor të vitit 2018, projekti i quajtur “Rrjeti i Kosovës për arsim dhe punësim”, në kapitullin e arsimit të përgjithshëm (niveli fillor, i mesëm i ulët dhe i lartë) ka rezultuar me këto statistika: 77.7% e shkollave në nëntë komuna të Kosovës nuk kanë psikolog shkollor; 42.6% e këtyre shkollave nuk posedojnë internet në kabinetet e lëndës së Tik-ut, duke shtuar edhe mungesën e bibliotekave dhe të transportit për nxënësit që udhetojnë nga larg etj. Këta janë vetëm disa nga faktorët që ndikuan në renditjen e Kosovës në vendin e tretë nga fundi në testin PISA-s 2018.

Ku qëndron problemi? Jam i vetëdijshëm se mesazhi i këtij shkrimi nuk do të arrijë tek institucioni përgjegjës për këto rezultate e statistika, mirëpo ky shkrim do të kalojë në duart e dikujt, e i cili do të mendojë pak për këto gjëra.

Gjithsesi duhet drejtuar gishti edhe ndaj atyre nxënësve të përgjumur e që pjesërisht janë përgjegjës për gjendjen e arsimit në vend, nxënës që nuk janë në gjendje të lexojnë as një libër në vit jashtë planprogramit të tyre shkollor, e që fatkeqësisht i kanë mbushur bankat shkollore.

Përpos kësaj që u tha, konsideroj se arritja e vetë-disiplinës, apo mposhtja e egos nga ana e nxënësit, është sfida kryesore drejt suksesit.

Ja disa hapa drejt mënjanimi të sfidave:

a) Menaxhimi i drejtë i kohës. Ky është një hap mjaft i rëndësishëm për veprimtaritë e nxënësve.

Çka do të ndodhte sikur nxënësit tanë të bënin një plan-program të mirëfilltë në lidhje me gjumin e tyre? Fatkeqësisht kjo është një ndër sfidat më të rënda për nxë-

nësin. Pra, çrregullimi i procesit të gjumit.

b) Rënditja e çështjeve me prioritet. Edhe në këtë hap dështojnë një numër i konsideruar i nxënësve. Shumica e tyre preokupohen me çështje sekondare dhe me të ardhmen e tyre, siç është martesë, punësimi etj.

c) Shfrytëzimi profitprurës i teknologjisë. Edhe pse shkollat tona kanë mungesë të mjeteve teknologjike, nxënësit nuk e kanë të njëjtin fat. Zhvillimi i teknologjisë sot është në kulm, prandaj shekulli aktual nga ana e sociologëve e ka marrë epitetin “Shekulli i teknologjisë”. Shfrytëzimi jo i drejtë i këtyre mjeteve, apo thënë ndryshe, ndjekja e skenave shthurëse pornografike, shfrytëzimi i tyre për dukurinë e shëmtuar të bulizmit etj., ka bërë që shumë nxënës të lënë në harresë aplikacione të mirëfillta e të dobishme, aplikacione që përveç njohurive shkencore, mundësojnë edhe mësimin e ndonjë gjuhe, dhe ky është një hap mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj.

ç) Përgatitja apo shkrimi i planeve. Një hulumtim i bërë me studentët e një universiteti prestigjioz në Amerikë ka rezultuar se studentët që kanë bërë përgatitjen apo shkrimin e planeve dhe synimeve të tyre kanë qenë shumë më të suksesshëm në krahasim me palën tjetër që ka çaluar në këtë pikë.

d) Mbështetja në Zotin e Madhërishëm. Koncepti i religjionit pashmangshëm luan rol të madh në jetën e secilit njeri, e sidomos në jetën e nxënësit. Pasi populli i Kosovës me shumicë absolute i përket besimit Islam, duhet përmendur parimin islam të ashtuquajtur “tevekul”- të mbështeturit në Zotin. Parimi i tevekulit ka të bëjë me marrjen e shkaqeve dhe kryerjen e punës me përsosmëri, gjithherë duke qenë i mbështetur në Zotin e Madhërishëm.

Pas ndjekjes së këtyre hapave, shpresoj që nxënësit e vendit tonë do të vetëdijesohen. Përndryshe, gjendja e këtillë që i ka kapluar nxënësit, apo “gjendja e përgjumur”, do ta zhytë shoqërinë në një humbje edhe më të thellë.

Seid Arbanashi, 12/3

NXËNËS TË SUKSESSHËM

1. Unë jam Lindita Makolli. Aktualisht e vijoj mësimin në “Medresenë e Mesme Alauddin”, në Prishtinë. Jam nxënëse e paraleles 11/4.

Jam sportiste, dhe ushtroj në artet marciale, në sportin Taekwondo. Tash e tre vjet bëj ushtrime në këtë sport. Ky sport më ndihmon të jem më e fortë, më e fokusuar dhe më e shkathët. Ky sport lindi në Korenë Jugore. Taekwondo është sport luftarak i cili u zhvillua gjatë viteve 1940-1950, ndërsa në Kosovë erdhi diku në vitin 1998. Federata e Teakwandos në Kosovë u themelua në vitin 2001. Arsyja pse zgjodha të ushtroj pikërisht në këtë sport është kreativiteti që ka ky sport. Deri tani kam marrë pjesë në 4 gara kombëtare dhe ndërkombëtare, si:

“Tirana Challenge” - vendi i 3-të

“Tirana Trophy”, - vendi i 2-të

Kampionati i Kosovës, - vendi i 1-rë

“Top Tirana Open 2019”, - vendi i 2-të

Synimet e mia në këtë sport janë që një ditë të bëhem zotëruese e këtij sporti, dhe t’ua mësoj edhe brezave të ardhshëm.

2. Unë jam Suhejla Franca. Vijoj mësimet në Medresenë e Mesme Alauddin në Prishtinë.

Jam nxënëse e paraleles 10/3. Besoj se kam një prirje të theksuar, një shkathtësi, e që është të folurit në publik.

Shkathtësitë e të folurit në publik i referohen talentit të adresimit në mënyrë efektive të një audience. Pavarësisht nëse folësi është përpara një grupi njerëzish që tashmë i njeh, ose një turme të panjohurish, aftësia për t’ua komunikuar atyre me qartësi dhe besim njihet si aftësi e të folurit në publik.

Gjatë kohës që flas para një audience kam besim më shumë në vetvete, dhe gjithashtu më bën të ndihem mirë. Kam qenë pjesë e disa organizatave dhe garave, duke e përfshirë edhe Toast Masters. Synimi im është të jem pjesë e ‘TEDx’.

Gëzohem që kam këtë prirje, pasi do jetë pjesë e jetës kudo që të jem, dhe gjithashtu do të më ndihmojë edhe në fokusim, përqendrim dhe vetëbesim më të lartë.



3. Unë jam Sumeja Makolli. Si e vogël gjithmonë kam qenë një tip me energji dhe e kam dashur sportin, sidomos vrapimin. Të ndalesh te baza e çdo sporti është tjetër nivel i dashurisë për sportin. Sporti për mua ka qenë veçse një shikim dashurie që më ka bërë pjesë të veten; kam qenë e përkushtuar në stërvitje, edhe pse me pauza kohore të caktuara për arsye të lëndimeve.

Vullneti ka qenë çelësi i çdo motivi që ka lejuar trupin tim të vazhdojë me këtë disiplinë.

Nuk ka qenë e lehtë të mblidhja veten te një pikë që të më shtynte çdoherë tutje, sepse pjesa e stërvitjes është më problematike, mirëpo serioziteti i punës nuk më ka lënë kurrë poshtë.

Kam qenë garuese në disiplinat e shkurtra 100m, 200m, 300m, por nuk kam arritur rezultat të mirë (14.07-100m) për kualifikim jashtë Kosove.

Tani vazhdoj të jem garuese e disiplinave të mesme 800m-1500m, dhe po përparoj mjaft mirë me rezultate. Gjithsesi atletika ka qenë dhe do të mbetet një pasion për mua, edhe nëse jo cak i një qëllimi në jetë. Gjithashtu merrem edhe me skijim, që nga mosha 4 vjeçare, kur për herë të parë provova veten mbi një sfidë ndryshe nga ecja. Kam plot 14 vjet që jam pjesë e kësaj mrekulie. Çdoherë sfidohem me terrene nga më të ndryshmet. Ndonëse edhe e trashëguar, gjithmonë me forcat e mia kam provuar të eci tutje. Babai im ka qenë instruktor dhe motivi im gjatë kësaj kohe.

Ndryshe nga atletika, skijimi përveç pasionit ka marrë edhe një drejtim tjetër në jetën time, pra si qëllim. Shumë shpejt në këtë fushë do të jem triumfuese dhe përfaqësuese e Kosovës. Jam e bindur se me dëshirë, vullnet, punë dhe durim do ta arrij titullin. Njeriu mund të arrijë çfarëdo që dëshiron në jetë vetëm nëse vërtet e kërkon atë!







Klasa 10/3 | Kujdestare: **Shahë Memishi**



Klasa 10/4 | Kujdestare: **Hatixhe Simnica**



Klasa 11/1 | Kujdestar: **Shkëlzen Hoxha**



Klasa 11/2 | Kujdestar: **Muharrem Tërnavë**





Klasa 12/1

Kujdestar: Ekrem Maqedonci



Klasa 12/2


Kujdestar: Driton Arifi



Klasa 12/3 | Kujdestar: **Besnik Jaha**



Klasa 12/4 | Kujdestare: **Hatixhe Simnica**



NJË NISMË E MBARË E BASHKPUNIMIT TË NXËNËSVE TË DY SHKOLLAVE TË MESME TË PRISHTINËS

Më 19.02.2021, nxënësit tanë, Rijad Krasniqi dhe Harith Abazi realizuan një intervistë, e cila bën fjalë për format e vijimit të procesit mësimor gjatë pandemisë COVID-19 nëpër disa shkolla të Prishtinës.

Prononcimi për intervistë u bë nga Këshilli Rinor i Nxënësve të Shkollës “Ahmet Gashi”, respektivisht nxënësit Denis Krasniqi dhe Ismet Krasniqi.

Kjo intervistë u projektua të zhvillohet edhe në shkollat e tjera të mesme të Prishtinës, dhe po ashtu ky aktivitet konsiderohet edhe si një urë bashkëpunimi mes nxënësve tanë dhe nxënësve të shkollave të tjera të Prishtinës.

INTERVISTË ME ANËTARË TË SHKOLLËS “AHMET GASHI”

Nxënësit e Medresesë së Mesme Alaaddin organizuan disa intervista me nxënës të disa shkollave të mesme të Prishtinës, e në këto intervista ata diskutuan shumë gjëra, megjithëse tema kryesore ishte se si po kalohej mësimin në pandemi.

Në vazhdim e kemi intervistën e tyre me nxënës nga shkolla e mesme “Ahmet Gashi”, respektivisht me nxënësin Denis Krasniqi.

Drita e Kuranit: Përshëndetje! Jemi këtu në shkollën “Ahmet Gashi, e me ne është anëtar i kryesisë së shkollës “Ahmet Gashi”, nxënësi Denis Krasniqi, të cilin e falënderojmë që ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe diskutuar për ura bashkëpunimi në mes shkollave tona.

Denisi Krasniqi: Ju falënderoj që keni gjetur kohë dhe e keni vlerësuar shkollën “Ahmet Gashi”, që të mund të ju ndihmojmë jo vetëm ju, por edhe shoqërisë.

Drita e Kuranit: Faleminderit Denis! Po fillojmë me pyetjet që i kemi përgatitur. A mund të jepni një prononcim se si është përballur kolektivi dhe nxënësit në këtë situatë të pakëndshme të shkaktuar nga virusi Covid-19?

Denisi: Situata ka qenë e panjohur që nga fillimi, dhe kemi hasur në disa vështirësi që askush nuk është përballur më herët me to. Mirëpo me këshillat e drejtorit të shkollës, profesorëve dhe të nxënësve, ne si nxënës kemi fituar një lloj edukate se si duhet të sillemi në këtë periudhë, pra që ta ruajmë veten dhe rrethin tonë, e kjo është

futur në mendjet tona, dhe besoj se ka ndikuar pozitivisht në menaxhimin e situatës me Covid-19 jo vetëm në shkollën tonë, por edhe në shoqërinë dhe rrethin tonë.

Drita e Kuranit: Sa kanë bashkëpunuar nxënësit me kolektivin dhe drejtorin e shkollës në bazë të planifikimit të parashikuar nga Ministria e Arsimit?

Denisi: Atëherë, ne si kolektiv i shkollës, duke përfshirë edhe nxënësit dhe profesorët, kemi marrë një këshillë nga Ministria e Arsimit, që të hapet një organ i ri, që është task-forca, e që kanë qenë të hapura në dy vende, ku kanë qenë të rezervuara për ne që kemi pasur të drejtë vote dhe të drejtë propozimi për idenë se si duhet të zhvillohet mësimi në javët e ardhshme, dhe kështu kemi pasur një






REPUBLIKA E KOSOVËS
BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
MEDRESEJA E MESME "ALAUDDIN"
PRISHTINË




قُلْ لَدَيْ سَيِّدِي الْأَعْرَافُ إِلَى اللَّهِ عَلَى بَصِيرَةٍ وَأَنَا مِنَ اتَّبِعِي
"Thuaj: "Kjo është rruga ime, në të cilën thërres në bazë të një
vizioni të qartë, unë dhe të gjithë ata që më pasqinë mua..."

Sunja, Juma, 108

KLASA 12/3



KLASA 12/1





Hyrri Bajraktari
Direktor i Institucionit



Mr. Elmiri Arifi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Rrahman Arifaj
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Mr. Shemsi Shemsi
Zëvendësudhëheqës i Institucionit



Hatirë Sarini
Supervisor



KLASA 12/4



KLASA 12/5



Mr. Samir Ahmeti
Supervisor



Albertina Begaj



Alketa Osmanli



Alma Halili



Anisa Durguti



Anesa Allu



Anisa Durguti




Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anisa Durguti



Anjolina Shabta



Arifina Lami



Arzona Avdullu



Azra Sahli



Beslinda Shanoj



Bukurije Haziri



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Diana Rashiti



Elira Krasniqi



Elina Zenebi



Era Ibrahim



Erolina Kasumi



Gendiana Arifi



Hajrije Berisha



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Lera Lahi



Luljeta Klitaka



Mirela Ibrahim



Mirina Zhushi



Saima Gashi



Sahaja Xhigali



Samirë Makolli



Sunijë Hajdini



Zhanna Krasniqi



Zylfije Koca



Mijana Berisha



Nikadese Gashi



Ruzdita Mehmeti



Ruzdita Mehmeti



Ruzdita Mehmeti



Ruzdita Mehmeti



Ruzdita Mehmeti



Ruzdita Mehmeti



Ruzdita Mehmeti

"Por ti madhëroje me falënderime Zotin
tënd, dhe bëhu prej atyre që lutën!
Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të
të vijë vdekja!"
(Kuran: 15:98-99)

Gjenerat e 20-të
Të kësaj viti 2021

bashkëpunim të shkëlqyeshëm me drejtorin e shkollës dhe me profesorët, e kjo na bëri që ne të kishim mundësi ta vazhdojmë procesin mësimor pa pengesa, e që në shkollat e tjera i kanë pasur.

Drita e Kuranit: Ne e dimë që shkolla juaj për një periudhë kohore ka qenë në karantinë. A mund të na shpjegoji se si është plotësuar platforma mësimore në kohën e karantinës?

Denisi: Me rritjen e rasteve në shkollë ne si task-forcë u detyruam që ta mbyllim shkollën dhe ta fusim në karantinë, dhe për dhjetë ditë është bërë e mundur të shtrihet rrjeti në tërë shkollën, pastaj profesorët kanë ardhur në shkollë dhe kanë mbajtur mësimin, dhe kështu ne kemi qenë në shtëpi duke e ndjekur mësimin përmes platformës "Zoom". Mendoj se ka qenë shumë e suksesshme si teknike, përkundër faktit që asnjëherë më parë nuk kemi pasur kështu lloj mësimi.

Drita e Kuranit: Çfarë mendoni për mësim-nxënien nga ana e nxënësve? A ka pasur rënie të kualitetit të mësimit gjatë kësaj situatë pandemie?

Denisi: Vështirësitë që i përmenda edhe më parë nor-

malisht se kanë krijuar disa pengesa, e që disa kanë qenë më të vështira, e disa më të lehta. Përkundër motivit që e kanë pasur, edhe nxënësit po edhe profesorët, prapë kemi vërejtur se cilësia ka rënë, dhe gjendja jonë psikologjike, në përgjithësi ka qenë pak më e dobët sesa herëve të kaluara. Kjo sepse kishim situatë komplet tjetër, dhe nuk kemi pasur rast më parë të ballafaqohemi me diç të ngjashme. Pra, po, është vërejtur një rënie, edhe pse jo është shumë dalluese nga vitet e kaluara.

Drita e Kuranit: Denis, si anëtar i Këshillit të Nxënësve në shkollën "Ahmet Gashi" ju falënderoj shumë për kohën tuaj dhe interesimin tuaj për bashkëpunim. Shpresojmë që sa më shpejt ta kalojmë këtë situatë bashkërisht, dhe të mund të organizojmë shumë aktivitete!

Denisi: Faleminderit edhe prej jush! Jeni të mirëseardhur sa herë që të dëshironi!

Intervistoi: Rijad Krasniqi

Nxënësi: Denis Krasniqi (Ahmet Gashi)

Bashkëpunoi: Harith Abazi, Emir Mehani



INTERVISTË ME ANËTARË TË SHKOLLËS “XHEVDET DODA”

Drita e Kuranit: Përshëndetje! Jemi këtu në gjimnazin e Shkencave Natyrore “Xhevdet Doda”, dhe këtu kemi anëtarin e këshillit të shkollës, Sonila Pllashniku. Përshëndetje, Sonila!

Sonila: Përshëndetje Harith, dhe mirë se keni ardhur në shkollën tonë. Po shpresoj se kjo intervistë do të jetë shumë frytdhënëse për shikuesit dhe, meqë është bashkëpunimi i parë mes shkollave tona, po shpresoj se kemi filluar me këmbë të mbarë, dhe se bashkëpunimet nuk do të ndalen!

Drita e Kuranit: Tema e kësaj interviste është se si e keni kaluar mësimin ju si shkollë, pra, gjatë pandemisë. Po fillojmë me pyetjen e parë: cili ka qenë reagimi juaj kur keni kuptuar se virusi ka arritur në Kosovë dhe se janë shfaqur rastet e para?

Sonila: Edhe unë, sikur të gjithë, kam qenë në stres dhe panik, por kam qenë më shumë e shqetësuar për mësimin, se si do të zhvillohet gjatë kësaj periudhe, duke pasur parasysh se asnjëherë nuk kemi mbajtur mësim online, dhe asnjëherë nuk kemi qenë të izoluar. Pra ky ka

qenë shqetësimi im.

Harithi: A mund të thoni se sa kanë qenë nxënësit bashkëpunues me kolektivin dhe Drejtorinë e shkollës, e cila e ka organizuar mësimin e planifikuar nga Ministria e Arsimit?

Sonila: Mund të them se jam befasuar shumë nga bashkëpunimi i mësimdhënësve me nxënësit, e po ashtu edhe nga Drejtoria e shkollës, për arsye se ne e dimë se raporti në mes mësimdhënësve dhe nxënësve është strikt. Mirëpo, për shkak të pandemisë dhe situatës së jashtëzakonshme që është shkaktuar, këtë herë është dashur të bëhen disa lirimë dhe të formohet një raport më i afërt, duke pasur parasysh se gjatë gjithë shkollës kemi qenë online. Kjo ka rezultuar si bashkëpunim i suksesshëm.

Drita e Kuranit: Ne e dimë se shkollat për një periudhë kohore kanë qenë të izoluar. A mund të na tregoni se si është plotësuar planprogrami të ju gjatë kësaj periudhe?

Sonila: Diku para një viti në këtë kohë Ministria e Shëndetësisë na ka lajmëruar se shkollat duhet të mbyl-
len, dhe ne kemi filluar në ditën e dytë, menjëherë me



platformat e ndryshme online, fillimisht kemi provuar platformën “Zoom”, ku kemi mbajtur takime virtuale, në të cilët takime profesorët kanë shpjeguar dhe nxënësit kanë dëgjuar, e pastaj me platforma tjera si “Google Meet”, “Google Classroom”, ku kemi mundur t’ua dërgojmë edhe detyrat tona, pastaj të bëjmë projekte, dhe kuize e teste online, si në “Kahoot” etj. Kjo pa dyshim se ka dalë si sukses në procesin mësimor në shkollën tonë.

Drita e Kuranit: Pasi jemi te platformat mësimore “Zoom”, “Google Classroom” etj., a mendoni se ka pasur rritje të kualitetit të mësimin të nxënësit, apo e kundërta?

Sonila: E dimë se mësimi në klasë nuk krahasohet me mësimin online. Mënyra e shpjegimit dallon nga shpjegimi prapa një monitori, e kjo tregon se nuk ka qenë sukses shumë i madh. Mirëpo nuk mund të them se ka pasur rënie të kualitetit të mësimin. Ka pasur nxënës që ndoshta nëpër shkolla nuk kanë qenë shumë aktivë, kurse në mësim online kanë dërguar komente private dhe kanë qenë të detyruar të jenë aktivë, dhe ka pasur nxënës që

kanë rritur sukses të madh. Me një fjalë, mund të them se nuk krahasohet mësimi në shkolle me mësimin online, edhe pse edhe ky i fundit i ka pasur anët e veta pozitive.

Drita e Kuranit: Kjo ndoshta është sepse çdo nxënës e ka personalitetin e vet dhe dallon prej të tjerëve. Sonila, të falënderoj për kohën që e keni ndarë sot që të diskutojmë bashkë për mësimin në shkollën tuaj gjatë pandemisë!

Sonila: Ju falënderoj edhe unë ju që keni ardhur! Jam shumë e lumtur që bashkëpunimi ynë i parë është me këtë lloj interviste, për ta dhënë një mesazh për lexuesit, dhe të tregojmë se si është zhvilluar mësimi në shkollën tonë gjatë kësaj kohe. Shpresoj se bashkëpunimet mes nesh do të vazhdojnë edhe vitin tjetër!

Drita e Kuranit: Shpresojmë edhe ne! Faleminderit!

Intervistoi: *Harith Abazi*

E intervistuar: *Sonila Pllashniku*

Ndihmës: *Rijad Krasniqi & Emir Mehani*



THËNIET E MATURANTËVE

KLASA 12/1

1. Aldin Stublla: "Thoni: "Boni Bismil-lah!"
2. Amir Hoxha: "E mundshmjia" e pyet "të pamundshmen": "Ku jeton?" - U përgjigj: "Në ëndrrat e të paaftëve."
3. Amir Ramabaja: "Në barnatore mos i zgjidh ilaçet për nga paketimi, sepse edhe helmi ka paketim të bukur!"
4. Arianit Shala: "Inshaallah, po p'shtojmë!"
5. Astrit Spahiu: "Lakmia për pasuri shumë zemra i bëri të dashurojnë pa ndjenja."
6. Beis Islami: "Top Boy S3 E7 50:51."
7. Besim Tërshani: "Jetojmë në një botë ku kultura e ambalazhit e urren përmbajtjen."
8. Bledion Idrizi: "Ujku qimen e ndërron, po zanatin s'e harron."
9. Bleron Zeqiri: "Yesterday is history, tomorrow is a misery, but today is a gift that is why it's called the present."
10. Elion Vitija: "Urrejtja është sikur të pish helm dhe të shpresosh se do të vdesë dikush tjetër."
11. Endrit Hoxha: "Miqësia është sikurse pusi, sa më tepër nxjerrë nga ajo, ajo bëhet më e thellë."
12. Erblin Kastrati: "E ardhmja u përket atyre që besojnë në bukurinë e ëndrrave të veta."
13. Gentian Rexha: "Edhe fjalët krejt i lidhi, si vetë, pa kup-tim."
14. Jon Thaqi: "Largimi më i bukur është largimi pa lënduar, falja më e bukur është falja pa qortim, dhe durimi më i bukur është durimi pa ankim."
15. Kastriot Alushaj: "Vetëm të ngriturit në dituri dinë të thonë 'nuk e di'."
16. Lis Bekaj: "Ti mëson nga gabimet, mirëpo ne nuk merremi vesh."
17. Muhamed Kaçiu: "Live your life and forget your age!"
18. Muhamed Sogojeva: "Nëse nuk mund të jesh lapsi që vizaton buzëqeshjen në jetën e atyre që do, atëherë bëhu goma që fshin vuajtjet e tyre!"
19. Osmon Çunaku: "Dije se e mira jote nuk i bën mirë Allahut, mirëpo i bën mirë vetes tënde!"
20. Samed Deliu: "Nëse dëshiron të bëhesh zgjidhësi i një problemi, shiko fillimisht te vetja, se ndoshta ti mund të jesh problemi kryesor!"
21. Samir Pacolli: "Kultura është gjithçka që nuk ta ka dhënë natyra, mirëpo e ke krijuar vetë."
22. Shabin Krasniqi: "Çka humbe, mos e kërko, ç'ke në dorë, mos e lësho!"
23. Shuajb Bardhi: "Falling down is an accident. Staying down is a choice."
24. Ubejd Shiti: "I was always late, but right in time."
25. Uvejs Murati: "Nuk përfitohet dituria pa frikë ndaj Allahut: "Po, Allahut ia kanë frikën ata që prej robërve të Tij janë dijetarë." (Fatir: 28)."



THËNIET E MATURANTËVE

KLASA 12/2

1. *Albesian Pajaziti: "Librat janë miqët më të qetë dhe më të përhershëm. Ata janë këshilltarët më të gjendshëm dhe më të mençur, si dhe mësuesit më të durueshëm."*
2. *Alzan Ujkani: "Shko me besim drejt ëndrrave tua! Jetoje jetën që imagjinon!"*
3. *Ammar Zariqi: "Beso se mundesh, dhe je në gjysmë të rrugës!"*
4. *Amir Azemi: "Shumë gjëra t'i kapë syri, mirëpo ndiqi ato që t'i kapë zemra!"*
5. *Ardit Berisha: "Çdo gjë që kërkon është në anën tjetër të frikës."*
6. *Amir Berisha: "Fillo aty ku je! Përdore atë që ke! Bëje atë që mundesh!"*
7. *Enes Dedija: "Rri larg njerzve që kanë përgjigje për çdo gjë dhe nuk e pranojnë asnjëherë që e kanë gabim!"*
8. *Emir Baktiri: "Show me your friends, I'll show your future!"*
9. *Endrit Pajaziti: "Jeta zvogëlohet ose zgjerohet në proporcion të kurajos së dikujt."*
10. *Enes Hajdaraj: "Hakmarrja më e mirë është suksesi material."*
11. *Ensar Abdullahu: "Ose ti e bën ditën tënde, ose dita të drejton ty."*
12. *Erion Pajaziti: "Ne bëhemi çfarë mendojmë."*
13. *Ermal Demolli: "Çdo dhembje jep një mësim, dhe çdo mësim e ndryshon njeriun."*
14. *Esad Musliu: "Njerëzit që kafshojnë dorën e atij që i ushqen zakonisht lëpijnë këpucët e atyre që i godasin."*
15. *Labinot Bajraktari: "Ka vetëm dy kohë në jetë: TANI, dhe SHUMË VONË."*
16. *Ferid Gashi: "Make your life a masterpiece; imagine no limitations on what u can be, have or do!"*
17. *Huvejd Neziraj: "Sado të dish, prapë thuaj nuk di! Në jetë mos shit, por blej dituri!"*
18. *Imri Curri: "Mëso të vlersosh atë që ke përpara se koha të të mësojë të vlersosh atë që kishe!"*
19. *Ismail Mahmuti: "Be somebody who makes everybody feel like a somebody!"*
20. *Muhamed Zeqiri: "Mos u ngut të zësh miq, por kur t'i zësh, mos i braktis!"*
21. *Resul Sijarina: "Jetim nuk është ai që s'ka prind, por ai që s'ka mend!"*
22. *Suhejb Ademi: "Ai që nuk ka bërë asnjë gabim, nuk ka provuar asgjë të re."*
23. *Shkëlqim Bivolaku: "Miqësia është si shkëmbi, dhe atë nuk e prish përveçse çekiçi i tradhtisë."*
24. *Ubejd Ademi: "Më pëlqejnë njerëzit që janë të heshtur dhe që, kur flasin, i heshtin të tjerët."*
25. *Zejd Gashi: "Sa herë ta gjesht veten në anën e shumicës, është koha të reflektosh dhe të ndryshosh."*



THËNIET E MATURANTËVE

KLASA 12/3

1. *Abdurrahman Peci: "They say you are what you eat, but I don't remember eating a goat."*

2. *Ajdin Llapashtica: "Qetësia është burim i fuqisë."*

3. *Amir Musa: "Duaja është dhurata më e shtenjtë që ia dhuron atij që e do."*

4. *Arlind Peci: "Përderisa është dikush në qiell që më mbron, s'ka njeri në Tokë që më mposht."*

5. *Arnës Ejupi: "Every day is a day you've never seen before."*

6. *Bajram Asllani: "As long as you have Allah, you have no reason to lose hope or give up."*

7. *Beis Lushta: "Njeriu e arrin kulmin e kënaqësisë kur e pranon se caktimi i Allahut është më i mirë për të."*

8. *Driton Sabiti: "Mos harro se arma më e fortë ndaj tradhtisë është sjellja e mirë, ngase tradhtia ta vret ndjenjën, por jo edhe shpirtin!"*

9. *Edon Sijarina: "Master has given Edon a high school diploma, Edon is Freee!"*

10. *Elmedin Fejzullahu: "Modestia, buzëqeshja dhe fjala e mirë janë gjërat më të bukura që lë njeriu në zemrat e të tjerëve."*

11. *Enes Musliu: "Speak the truth, even if your voice shakes!"*

12. *Enis Fejzullahu: "Jo, s'e kom asgjë Sabri Fejzullahun."*

13. *Ergin Kosumi: "Ashtu siç e vlerëson veten, në atë mënyrë do të të trajtojnë njerëzit."*

14. *Esne Bejta: "Bruh, we graduated just to go to school again. Uh!"*

15. *Fation Bekolli: "E qeshura nuk do të thotë se je gjithmonë i lumtur, thjesht do të thotë që je një person i fortë."*

16. *Festim Ismajli: "Të gjithë trupat ushqehen me materie, ndërsa shpirti me besim."*

17. *Fuad Basholli: "Lumturia nuk është diçka që të jepet e gatshme. Ajo vjen nëpërmjet veprimeve tua."*

18. *Hamed Llapashtica: "Take every day as a chance to be-*

come a better muslim!"

19. *Kushtrim Islami: "It doesn't matter how slowly you go as long as you don't stop."*

20. *Masar Ejupi: "Every day and every night never forget to say La Ilaha Illa Allah"*

21. *Muhamed Pllana: "E vërteta, rrugën e ka të gjatë, mirëpo vjen."*

22. *Muhamed Salihu: "Don't stop until you're proud!"*

23. *Omer Ismaili: "Janë disa miq që të bëjnë me besu se shtëpinë e ke tek ata."*

24. *Rejan Maçastena: "Close both eyes to see with the other eye!" (Rumi)*

25. *Rinor Gajtani: "Hapat nëpër konvikt janë disa tinguj që nuk i ndien askush përveç medresistit (...edhe edukatorëve)."*

26. *Seid Arbanashi: "Preokupimet dhe synimet tua janë pasqyrim i personalitetit tënd."*



THËNIET E MATURANTEVE

KLASA 12/4

1. Alberina Begaj: "Përgjigjja më e mirë për mendjelehtin është heshtja."

2. Alketa Osmani: "Çka janë krahët pa kurajën për të fluturuar?!"

3. Alma Halili: "Gjëja më e bukur që mund t'ia dhurosh dikujt është buzëqeshja, prandaj mos e kurse atë!"

4. Amira Durguti: "Ti sot je aty ku të kanë sjellë mendimet tua, dhe nesër do të nisesh nga aty ku do të të rrëmbejnë mendimet tua." (James Allen).

5. Anesa Aliu: "Kur ti dëshiron ta ndryshosh jetën tënde, por nuk di se nga t'ia fillosh, fillo me lutje!"

6. Anisa Durguti: "Bëhu si një lule e bukur për veten, e aromën shpërndaje te të tjerët!"

7. Anjesa Jasiqi: "Nëse nuk bëhesh rob i Allahut, mos u bëj rob i njerëzve!"

8. Argjenda Sfishta: "Në fund të ditës sytë tu kanë me dashtë me i pa veç pamjet që ta mbajnë ngrohtë shpirtin."

9. Arlinda Lami: "Nëse ti del nga Medreseja, Medreseja kur-
rë nuk del prej teje."

10. Arizona Avdulli: "E vërteta është e rëndë, dhe kërkuesit e saj janë pak."

11. Azra Sabiti: "Don't take life too seriously, no more makes it out alive!"

12. Beslinda Sinanaj: "Kujdes me sjelljet tua, sepse nuk mund të blesh gjithçka me para!"

13. Bukuriye Haziri: "Loti e shpreh atë që gjuha s'mund ta thotë."

14. Diana Rashiti: "Shumë prej nesh nuk i japin rëndësi një pjese të Islamit, e ajo është përmirësimi i sjelljes së moralit."

15. Elira Krasniqi: "The more kind you are, the more human you are."

16. Elma Zeneli: "Përhap dashuri kudo që shkon! Mos lejoni askush të vijë te ju pa u larguar më i lumtur sesa ishte!"

17. Era Hashani: "What held me together during those times was a promise I made to myself, take it slow. I would go on my plac, steadily."

18. Erblina Kasumi: "Don't sacrifice too much for others and treasure yourself more." (Kim Seokjin).

19. Gentiana Arifi: "Mos pritni besim prej atyre njerëzve që s'ta japin dot sinqeritetin!"

20. Hajrije Berisha: "I don't know where I'm going from here but I promise it won't be boring!"

21. Learta Lahi: "There are thoughts which are prayers. There are moments when, whatever the posture of the body the soul is on it's knees."

22. Lorena Rusinovci: "E bukur është ajo zemër kur në lutje kërkon të pamundurën."

23. Luljeta Klinaku: "Ajo që më së shumti e lodh shpirtin është fshehja e asaj që kemi nevojë ta shprehim."

24. Minire Rrahimi: "Nëse të pyesin për suksesin, thuaj se nuk e di rrugëtim më të suksesshme sesa rrugëtimi që shoqërohet me Kuran!"

25. Ndrina Zhushi: "Pse kur e themi fjalën "nder" na vijnë ndërmend gjithmonë vajzat, ndërkohë që ka meshkuj që me kohë e kanë humbur karakterin dhe nderin e tyre?!"

26. Saime Goxhufi: "This is the beginning of anything you want."


27. Subejla Xhigoli: "Përderisa je në këmbë, provo të ia japësh dorën dikujt që është rrëzuar!"

28. Sumeja Makolli: "Lufta është e humbur si pasojë e shkakut "dorëzim", dhe e fituar si fuqi e kundërvënies."

29. Sumejë Hajdini: "Njëherë ishte ëndrra... e tani ti do të mbetesh kujtimi më i bukur për mua, Medreseja ime."

30. Xhenneta Krasniqi: "Forget what hurt you, but never forget what is taught you!" (Kim Taeyoung)

31. Zylfije Zeka: "Jemi bashkudhëtarë drejt një jete të amshueshme."



THËNIET E MATURANTEVE

KLASA 12/3

1. Agesa Latifi: "Kjo botë është një rrugë kalimtare, dhe bota tjetër shtëpia e përhershme; rehatia dhe qejfet bëhen në shtëpi, dhe jo në udhëtim."

2. Ajna Hajdini: "Aty, në mesin e kujtimeve më të bukura dhe më të dashura të shpirtit, je ti, Medreseja ime."

3. Ajnë Elshani: "Rrugët e vështira shpesh çojnë në destinacione të mrekullueshme."

4. Alma Azemi: "Jam njeri në kërkim të kuptimit të njerëzores mu në mesin e njerëzve!"

5. Amire Kozhani: "Heshtja është mënyra më e mirë për t'i treguar dikujt se ka gabuar me ty."

6. Anesa Brahimi: "Make someone smile but never forget you're someone too!"

7. Arita Gashi: "Pse mos me punu kombat, edhe kombat kanë familje."

8. Arlinda Behrami: "Do të të dua përherë, sepse ti je det i artë i dijes, përvojave të ëmbla dhe shoqërisë së vërtetë..."

9. Aurita Bajraktari: "Ajo merrte forcë nga namazi, ja pse u bë e pamposhtur ndaj sprovave."

10. Dea Prapashtica: "When all else fails, take a nap."

11. Diellza Ibrahim: "When you can't find the sunshine, be the sunshine."

12. Drenusha Gjeli: "Kohë e artë."

13. Edita Lura: "Si të ta tregoj realitetin kur jetoj në gënjeshtër?!"

14. Eljesa Smajli: "Ti je rob i Allahut edhe pas medresesë."

15. Elma Cej: "You are somebody's reason to live. Happiness is being with you." (A.H.)

16. Elma Shehu: "Disa fjalë gjenden vetëm në lutje, jo në libra."

17. Fortesa Avdiu: "Medrese, arsyeja kryesore pse zemra ime buzëqesh."

18. Hafsa Dërmaku: "May the flowers remind us why the rain was so necessary!"

19. Kaltrina Arifi: "Nuk ka stoli më të bukur për njerëzit sesa singeriteti dhe kërkimi i hallallit." (Fudajl bin Ijad)

20. Lejla Ahmeti: "You can't make everyone happy, you're not pizza."

21. Merva Rustemi: "A professor is someone who talks in someone else's sleep."

22. Migena Berisha: "Zullumi s'ka skej."

23. Mirlinda Syl: "Sa të paktë janë ata që punojnë me singeritet vetëm për Allahun e Lartësuar, sepse shumë prej njerëzve duan që t'i shfaqin edhe adhurimet!"

24. Mukadese Gashi: "Do not judge me ok, I am a different person every 5 mins!"

25. Rinesa Gruda: "Për cilën kënaqësi të dynjasë po e humb ëmbëlsinë e shikimit në Allahun?!"

26. Rumejsa Mehani: "Ti je historia dhe thyesi i lapsit tënd."

27. Ruvejda Mehani: "Si mund të thuash se ke jetuar kur nuk ke një histori për të treguar?!"

28. Sanije Demaj: "Fillimi ishte i vështirë, mirëpo fundi qenka akoma më i dhembshëm. Je kujtimi më i bukur dhe vendi për të cilin malli do të më djegë përherë, Medreseja ime!"

29. Sumea Havolli: "How beautiful is that Allah will eagerly forgive you for the things you can't even forgive yourself for!"

30. Shukrane Tahiri: "The less you know, the better..."

31. Valentina Canolli: "Never touch important things of someone who's very good! Otherwise he becomes the worst person you know."



أهمية

الوقت هو حياة الإنسان على الأرض، و هو نعمة من الله سبحانه وتعالى أنعم بها على البشرية
قال النبي صلى الله عليه و سلم: نعمتان مغبون فيهما كثير من الناس: الصحة، والفراغ.
إذا ضاع وقتك ضاع عمرك، والوقت هو أهم مورد لديك، استخدام الوقت ستجعل حياتك أكثر إنتاجاً و فعالية وتذكر أنك ستحاسب عليك كذلك في الآخرة.
الوقت يمضي سريعاً ولكن لا نشعر به، إنه يمر دون أن نشعر به.
قال رسول الله صلى الله عليه و سلم: اغتتم خمسا قبل خمس: شبابك قبل هرمك، وصحتك قبل سقمك، وغناك قبل فقرك، وفراغ قبل شغلك، و حياتك قبل موتك.
قال ابن قيم الجوزية: و إذا أراد الله بالعبد خيراً أعانه بالوقت، وجعل وقته مساعداً له، وإذا أراد به شراً جعل وقته عليه وناكده وقته، فكلما أراد التأهب للمسير لم يساعده الوقت، والأول كلما همت نفسه بالعودة أقامه الوقت وساعده.
أجمل النصيحة التي أعطتنا إحدى من المعلمات هي: أقرأ كثيراً سورة العصر! (لتذكير أهمية الوقت)

Amira Durguti dhe Anisa Durguti

المدرسة أعطتني إياها ، لقد باركتني بها لبقية حياتي

إنه لأمر جميل عندما تعتقد أنه في وقت معيّن ، يرسل لك الله أصدقاء وصديقات لتسهيل رحلتك. أتينا من أماكن مختلفة ، ولم يكن يعرف بعضنا بعضاً جيداً ، وبدأنا نتحدث في صمت . . . و بدأنا في تكوين الصداقة.
بمجرد وجودنا معاً ، بدأنا نفهم بشكل أفضل موقفنا من الحياة الدنيا ، محاولين أن نذكر للصديقة بالهدف المشترك، بالمكان الذي لا يوجد فيه انفصال. في ظل عرش الله تعالى الذي نسعى إليه
بمجرد أن تجلب لنا الحياة التحديات والمحاكمات ، فنحن هناك ”متواجدين لبعضنا البعض لتتذكر الآية القرآنية: ”لا تحزن، إنّ الله معنا ولكن حتى في البهجة ، وبسعادة إحداها ، لا توجد إمكانية ألا تكون الأخرى أكثر سعادة.
سعيد من وجد صديقاً يستحق هذا الاسم. وبقدومنا إلى هذه المدرسة ، فقد أنعمنا الله بنعم شتى ، فمن بينها إيجاد صداقة حقيقية في الوقت الذي يمكن أن يرتكب فيه المراهقون الكثير من الأخطاء ، أصبحت الصديقات نوراً للحقيقة. لقد أصبح مصدر ارتياح لنا من جميع النواحي، فهن أصبحن أخواتنا. لقد تعارفنا بهنّ هنا ، ولن ينسى بعضنا بعضاً لطيلة بقية حياتنا
أخط هذه الكتابة من من عمق قلبي مباشرة إلى قلبك شكراً لكونك ووجودك هناك بالنسبة لي في كل مرة وأشكرك على إخباري بأنك ستكونين ويدوم وجودك إلى الأبد
الشيء الأكثر تميزاً أنه حتى بعد المدرسة سأذكرك بشوق، يا صديقتي

Arlinda Behrami, 12/5

IN MY MIND

Have you ever thought what is going on in our minds? A lot of people in it, a lot of drama things, and a lot of beautiful things that can't be described in words.

Sometimes, just close your eyes and you will be in your imagination, inside of it and it feels like you're living with that dream, that you build on your own. Sometimes you lose all your hopes but believe me, there's still another one that tells us to never give up. No matter what you do, how many times you try and fail, u will always have the power to continue and to use that last hope because in the end u will make things successfully, by believeing in yourself, and telling urself how strog u are.

There will always be a hope for everything, just don't give up, things aren't as u see until you try and feel them yourself.

Jeta Islami, 11/3

~Gerçek dost gölge gibidir.
Eğilsen de, doğrulsan da, düşsen de, asla peşini bırakmaz. .

~Hayat bir imtihandır (sınavdır), istersen ya da istemesen onunla yüzleşmek zorundasın.

~Sustuysam, Rabbime bırakmışımdır. . .

~Kendinizi tüm kusurlarınızla gerçekten olduğunuz gibi kabul edin.

“Çok sabırlı olabilirim ama sabrım bittiğinde limanı yakarım, gemiyi değil.”

Ne güzel söylemiş Hz. Ali
“İnsanları tanıyan yalnızlaşır.”

Elma Murati, 11/4

أَقْدَسُ الْكُتُبِ

قَدْ أَنْعَمْنَا بِنُزُولِهِ، ظَهَرَ كَمُعْجَزَةٍ حِينَما تَحْدَى الْمُشْرِكِينَ فِي
الْإِتْيَانِ بِمِثْلِهِ، وَلَمْ يَغْلِبُوهُ أَبَدًا
عِلْمُ التَّفْسِيرِ يَدُلُّ عَلَى قِيَمَتِهِ
عَبْرَ التَّارِيخِ الْإِسْلَامِ هُنَاكَ الْعَدِيدُ مِنَ الْكُتُبِ فِي التَّفْسِيرِ،
عَلَى سَبِيلِ الْمِثَالِ: تَفْسِيرُ الطَّبْرِيِّ وَابْنِ كَثِيرٍ وَغَيْرُهُمَا
كَيْفَ يُمْكِنُ كِتَابَةُ كُلِّ هَذِهِ الْكُتُبِ لِتَفْسِيرِ كِتَابٍ وَاحِدٍ؟
وَلَوْ أَرَدْنَا مُقَارَنَةَ هَذَا الْكِتَابِ مَعَ كُتُبٍ مُخْتَلِفَةٍ قَدِيمَةٍ وَ
جَدِيدَةٍ، لَرَأَيْنَا أَنَّهَا تُفَرِّقُ وَ بَعْدَ فِتْرَةٍ تُتْرَكُ
وَهُوَ لَا يُتْرَكُ أَبَدًا
... أَنَا أَخْبَرْتُكُمْ عَنِ الْقُرْآنِ

Seid Arbanashi, 12/3



FOR MY FRIEND

“To my best friend, thank you for being you and for and for letting me be me. Thank you for letting me feel so much like myself when I’m with you. Thank you for not making me wear any masks or put on any fronts. Thank you sharing in my happiest moments; for listening to my saddest stories and radiating compassion and empathy from wherever you happened to be. Thank you for being the only person I ever want to confide in. Thank you for being the most beautiful person, inside and out. Thank you for making the world a better place just by being in it. Thank you for loving more fiercely than anyone I know. Thank you for the laughs, for the cries, and for everything in between. Thank you for all of the things you do, big and small. Thank you for always knowing what to say and for being one of life’s best teachers. Thank you for making fun of me when I deserve it, and for loving me when I don’t. Thank you for staying constant in a world full of change, and for keeping some normalcy in a world full of chaos. Thank you for making me hurt when I miss you. Thank you for loving me. Thank you for the absolute privilege and honor of being able to call you my best friend: thank you for being my person. Thank you for giving me these reasons, and a million more to be thankful for. Forever and always, Your best Friend”

Rinesa Zeneli, 11/3



MY SECOND HOME

Our school life is always the best time of our lives. Education is an essential part of our lives. We are nothing without knowledge, and education is what separates us from others. The main step to acquire education is enrolling oneself in a school. School serves as the first learning place for most of the people. Similarly, it is the first spark in receiving an education. My school is my second home where I spend most of my time. Above all, it gives me a platform to do better in life and also builds my personality. I feel blessed to study in one of the most prestigious and esteemed schools in the country (Madrasah Alauddin). In addition, my school has a lot of assets which makes me feel fortunate to be a part of it.

I see my school as a lighthouse of education bestowing knowledge as well as ethical conduct upon us.

If someone asked me what I have learned from my school, I won't be able to answer it in one sentence. For the lessons are irreplaceable and I can never be thankful enough for them.

To sum it up, studying in one of the respected schools has helped me a lot personally. I will always be indebted to my school for teaching me invaluable lessons. It has given me friends for life and teachers that I will always look up to. I aspire to carry on the values imbibed by my school to do well in life and make it proud.

School teaches us some of the great things like first of all, it gives us basic education. . Most importantly, it teaches us discipline.

Lale Lulaj, 10/4

İNATÇI OL

Bazen inat etmek iyidir!

Nasıl mı?

Düşersin ya hani; kalkmak gibi,

Üzülürsün ya hani; sabretmek gibi,

Yorulursun ya hani; pes etmemek gibi, Bazen inatçı olmak gerekir;

Kötülüğe karşı iyiliğe koşmak gibi.

Elma Murati, 11/4

WELCOME TO SOCIETY

We hope you enjoy your stay , and please feel free to be yourself , as long as it's in the right way , make sure you love your body , not too much or we'll tear you down , we'll bully you for smiling . And then wonder why you frown , we'll tell you that you're worthless.

That you shouldn't make a sound , and then cry with all the others , as you're buried in the ground , you can fall in love with anyone, as long as it's who we choose , and we'll let you have your opinions , but please shape them to our views.

Welcome to society.

We promise that we won't deceive and one more rule now that you're here.

There's no way you can leave !

Learta Labi, 12/4

VATËR E DITURISË

*Vatër diturie
Ngrohtësi shtëpie
Rehati shpirtërore
Vite kujtimore*

*Mësime të ndritura
Shkallë-shkallë të ngritura
Dritë gjithandej
Shpërnda ve ti te ne*

*Lule e pranverës
Freskia e verës
Shi vjeshte, burim
Borë dimri, vezullim*

*Fenë na e mësove
Imanin na e forcove
Fjalën e Zotit e lartëson
Margaritar që ndriçon*

*Mendjehapur të jemi
Zemërgjerësinë ta kemi
Butësinë ta posedojmë
Perla nga shkolla jonë*

Mirjeta Peci, 11/4

NANËS

*Fjalët e vujtuna t'ksaj zemre
n'fund vendosi me i thanë goja
gja ma t'bukur se emnin tand
kurrë pos NANË s'munda t'shqiptoja*

*N'dritë të llambës, n'fletë të bardhë
gum'zhin lapsi me randesë
ku t'gjej fjalët unë, he, i mjeri
të t'përkruaj ty mbretneshtë*

*M'dridhen buzë e mofshan' shpirti
kur menoj për vujtjet tua
krah't e tu si fortesë shkambi
Rozafat, kala mbi grua.*

Enes Musliu, 12/3

TË LARGOHEM

*Ndonjëherë,
Kur shpirtin e kam me mijëra ndjenja,
të miksuara,
të komplikuar,
të pathëna.
Të forta aq shumë sa gjoksi nuk i mban dot më,
Fjalët ndihen të varfra ta shkruaj gjendjen
time,
se nuk e flasin dot atë që e kam në zemrën time.
Them me vete: "Sot paskam nevojë të iki,
Të arratisem nga burgu i përditshëm,
Mos të eci në të njëjtën rrugë,
Mos të fle më në të njëjtin shtrat,
Mos të ëndërroj më të njëjtat ëndrra,
Mos të qaj më për personat që janë të gjallë e që
më mungojnë
Mos të bëhem e tepërt në asnjë vend,
Mos të vesh më të njëjtat ngjyra...".
Kam nevojë të largohem...
Përtej zburmës e qetësisë,
Përtej natës e ditës,
Larg çdo vendi e kobe.
Nën simfoninë e atmosferës poetike të flas me
melodinë e kujtesës dhe harresës.
Të iki në një tjetër jetë,
Nëpërmjet lutjes e pendimit,
Drejt takimit të përmallueshëm,
me Zotin tim.*

Elma Zeneli, 12/4

AJO KISH' HESHT'

*Ajo kish' hesht'
Që zemra e të tjerëve mos me u vra
Ë nuk shikonte veten
Që përbrenda copë-copë (i) ish ba*

*Ajo kish' hesht'
Që të tjerët dhimbjen e saj mos me e pa
Ë me ofshamat e lodhjes
Merzis' mundohej derman me i ba*

*Ajo kish' hesht'
Para njerëzve e dobët s'donte me u pa
Ë para Zotit të njerëzve
Sytë nga lotët asnjëherë nuk iu kishin tha*

*Ajo kish' hesht'
Ëdhe pse zemrën fort e kish mundu
Përbrenda n'luftë
Ë jashtë kinse pagën kish përqafu*

*Ajo kish' hesht'
Ë lumtur dukej
Me një buzëqeshje të lehtë
Ashtu ecte nëpër tokë...*

Adonita Arifi, 11/3

DASHURIA IME PËR TY

*Ndër lule të bukura, në kopshtin gjelbërues
nga malet te fluturat, ti me shpirt vezullues
sadaka për sytë, begati nga Zoti për mua
nuk e dimë të dy, pse kaq fort të dua.*

*Ajo fytyrë e nderuar, që bën dritë e nur
ajo buzëqeshje e tretur, nga zemra jote gur
sikur dimri i heshtur, i mbuluar me borë
diamanti i pagjetur, që s'ë prek çdo dorë.*

Yll Krasniqi, 11/2

DU PAK QETËSI

*du pak qetësi
ta ndi zanin e heshtjes që po m'flet tash e ca kohë*

*du pak qetësi
t'i ndiej rrëketë e lotëve t'njelmët që m'pikojnë dej
n'buz t'thata*

*du pak qetësi
ta ndi frymëmarrjen teme se si lyp pak ajër t'pastër
n'kët' ambient t'zymtë*

*du pak qetësi
t'i shoh kujtimet që u mishnuan n'kujtesën teme,
dhe që po ma brejnë shpirtin pak nga pak*

*du pak qetësi,
veç pak
pak
qetësi*

Enes Musliu, 12/3

PROMOVOVET LIBRI “VAJZA MISTERIOZE” I NXËNËSES BESAME JAKUPI

Në ambientet e shkollës sonë, në prani të drejtorit, mësimehënësve, nxënësve e familjarëve, u bë përurimi i librit të nxënësës sonë Besame Jakupi, me titull “Vajza misterioze”.

Të pranishmit me një fjalë rasti i përshëndeti drejtori Fadil Hasani, i cili e përgëzoi autoren për librin duke shtuar se tashmë nxënësja Besame Jakupi po i bashkohet vargut të nxënësve autorë librash të shkollës sonë, e kjo patjetër se është nder dhe shprehje e cilësisë së arsimit të Medresesë sonë.

Për të pranishmit më në detaje për librin ka folur redaktori Besnik Jaha, i cili theksoi se është për t'u vlerësuar si guximi ashtu edhe mbarështrimi i ideve të nxënësës Besame Jakupi.

Në fund, me një fjalë rasti të pranishmit i përshëndeti edhe kujdestarja e Besames, Valbona Asllani dhe vetë autorja dhe prindi i saj, duke e falënderuar drejtorinë për përkrahjen morale e materiale, si dhe të pranishmit për pjesëmarrje.



SHËNOHET DITËLINDJA E PEJGAMBERIT, A.S., DHE DITA E SHKOLLËS

Në ambientet e Medresesë së Mesme Alauddin, me një program të pasur u shënua ditëlindja e Pejgamberit, a.s., dhe njëkohësisht edhe 69 vjetori i themelimit të shkollës. Në këtë organizim morën pjesë drejtori i Medresesë, Fadil ef. Hasani, stafi i mësimehënësve, si dhe nxënësit.

Fillimisht manifestimi nisi me fjalët e Zotit të Madhëruar, e më pas fjala iu dha drejtorit të Medresesë, i cili çmoi dhe vlerësoi lart kontributin e Medresesë dhënë me dekada të tëra.

Fjalimi i drejtorit iu dedikua dy datave të mëdha, të cilat për nxënësit e Medresesë janë vetë misioni dhe vizioni gjatë shkollimit: shkolla si vatra kryesore e jetës, dhe Pejgamberi Muhamed, a.s., si model unik i njeriut në çdo kohë.

Manifestimi kishte përmbajtje të pasur artistike, me poezi e kaside kushtuar rëndësisë së shkollës dhe udhërrëfyesit hyjnor pejgamberik.

Krejt në fund nxënëset e klasës së 12-të shfaqën edhe një program mirëseardhjeje për nxënëset e klasës së 10-të. Organizatorët dhanë një program të pasur skenik, me përmbajtje atraktive artistike, me fokus përkrahjen dhe inkurajimin e nxënësve në rrugëtimin e përbashkët në jetën shkollë, si dhe në jetën e mëtutjeshme profesionale.

Njëkohësisht u respektuan masat anti-Covid 19, dhe numri i pjesëmarrësve ishte i reduktuar.



PROGRAMI I MATURANTEVE PËR KLASËN E 10-TË

Nxënëset e klasës së 12-të organizuan një program mirëseardhjeje për nxënëset e klasës së 10-të. Programi u hap me disa ajete nga Kurani fisnik, ndërsa më pas me një fjalë përshëndetëse uroi mirëseardhje në vitin e ri shkollor edhe drejtori Fadil Hasani, i cili nxënëseve ua uroi ardhjen në Medrese, duke u dëshiruar shëndet dhe suksese gjatë gjithë kohës sa do të jenë në Medrese.

Organizatorët dhanë një program të pasur skenik me përmbajtje atraktive artistike, me fokus përkrahjen dhe inkurajimin e nxënëseve në rrugëtimin e përbashkët në jetën shkollore dhe në projektet e reja të dijes.

Programi u mbajt me audiencë të kufizuar duke i respektuar rregullat anti-Covid-19.

Për atmosferën e programit shihni fotot në vijim!.



LIGJËRATË ONLINE: “SHËNDETI MENDOR GJATË PANDEMISË COVID-19”

Më datë 11 janar, disa mësimdhënës të Medresesë Alaeddin morën pjesë në ligjëratën online për ngritjen e vetëdijes rreth shëndetit mendor në mjetet shkollore gjatë COVID-19.

Ky takim u mundësua nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Universitetin e Prishtinës.

Kjo ligjëratë u mbajt nga Aliriza Arenliu, Kaltrina Kelmendi dhe Zamira Hyseni, profesoresha pranë Departamentit të Psikologjisë në UP.

Në këtë takim online pjesëmarrës ishin edhe drejtues të ndryshëm të institucioneve edukativo-arsimore, mësimdhënës e koordinator të shkollave të ndryshme të Prishtinës, e ndër ta edhe mësimdhënësit e shkollës sonë Shemsi Rrahimi, Luljeta Avdiu dhe Lirona Çerkini.

Qëllimet e ligjëratës ishin ngritja e vetëdijes për çështjet e shëndetit mendor gjatë procesit mësimor, gjegjësisht përgjatë pandemisë COVID-19, si dhe rekomandimi i aktiviteteve për punë praktike me nxënës që ngritin vetëdijen për shëndetin mendor dhe emocional.

Mësimdhënësve iu paraqitën të gjeturat nga studime të ndryshme në botë, ndër to dhe studimi i departamentit të psikologjisë në shkollat e Prizrenit dhe Kamenicës, për sfidat me të cilat përballen fëmijët dhe adoleshentët kosovar gjatë pandemisë COVID-19.



NXËNËSET E KLASËS SË DHJETË FILLOJNË LEXIMIN NË KURANIN FAMËLARTË

Një ndjenjë e papërshtuar me fjalë... Fjala e Allahut Fuqiplotë është fjala më e bukur në fytyrën e Tokës, dhe leximi (këndimi) i saj është më mbresëlënëses për besimtarët.

Pas dy muajve punë të përbashkët me klasat e 10-ta, duke filluar me mësimin e shkronjave kuranore, shkrimin dhe shqiptimin e drejtë të tyre, lidhjen e fjalëve dhe njohjen e rregullave elementare, falë Zotit u arrit hyrja në leximin e Kuranit fisnik!

Duke ditur rëndësinë dhe vlerën e këtij suksesi, me këtë rast prezantoi edhe drejtori i shkollës, Fadil Hasani, për çfarë edhe mbajti një fjalë rasti, ku ndër të tjera i porositi nxënëset që udhërrëfyes dhe shoqërues jetësor gjithmonë ta kenë Kuranin famëlartë.

Medreseja uron që ky sukses i nxënësve t'i paraprijë edhe shumë sukseseve të tjera në të ardhmen!

Drejtori i shkollës gjithashtu i përgëzoi të gjitha nxënëset për punën, si dhe e vlerësoi lart punën dhe angazhimin e profesoreshës Valbona Asllani, të cilën edhe e inkurajoi për projekte të reja.

DUAJA E HATMES SË MATURANTEVE


Në ambientet e amfiteatrit të Medresesë së Mesme Alaaddin, më 31 maj u organizua ceremonia e Duasë së Hatmes për nxënëset-maturante të gjeneratës së 20-të.

Duke pasur parasysh gjendjen pandemike, në këtë ngjarje u respektuan masat anti Covid-19, dhe ishin të pranishëm vetëm disa prej mësimdhënësve të shkollës, ndryshe nga ceremonitë e mëhershme kur ishin edhe prindërit.

Me këtë rast fjalë rasti mbajti drejtori i shkollës, profesor Fadil Hasani, i cili i uroi nxënëset për suksesin e arritur, si dhe u dëshiroi suksese edhe në të ardhmen. Gjithashtu fjalën e mori edhe profesoresha e Kuranit, Valbona Asllani, e cila tregoi përvojën e saj me këto nxënëse në lëndën e Kuranit, dhe i porositi që Kuranin ta kenë shoqërues të pandashëm të tyre përgjatë gjithë jetës. Më pas nxënëset i uroj edhe profesoresha Hatixhe Sadriu, duke i uruar e u dëshiruar suksese edhe më tutje.

Siç është traditë në Medrese, që pas fjalimeve të të ftuarve të shpaloset program, dhe këtë herë ndodhi njësoj: fillimi u bë me korin e vajzave, duke ia lënë radhën monologut të recituar prej nxënëses Hafsa Dërmaku. Programi vazhdoi me pikën kryesore, leximin e disa sureve të shkurtra dhe në fund u lexua Duaja e Hatmes në gjuhën arabe prej Ajna Hajdinit, si dhe në gjuhën shqipe prej Zylfije Zekës. Me kaq përfundoi ky program i veçantë, me shpresë që Allahu ta ketë pranuar atë lexim dhe dua.

Elma Zeneli, 12/4



7 MARS, DITA E MËSUESIT

Duke qenë se arsimimi ka një rëndësi të veçantë, jo vetëm për individin por edhe për shoqërinë, këtë shkrim kemi dashur t'ia kushtojmë konceptit islam për respektin për mësuesin dhe reflektimin e tij.

Respekti për mësuesin si reflektim i respektit për dijen

Njëri prej selefëve ka thënë: "Nuk arrihet dituria dhe as nuk përfitohet nga ajo përderisa nuk respektohet dituria dhe ithtarët e saj, si dhe nuk respektohen dhe nuk nderohen mësuesit." Pra, nuk do të bëhesh i ditur nëse nuk ke respekt për dijen dhe mësuesin! Dituria është çelësi që e ka hapur këtë fe.

Fjala e parë që i është shpallur Muhamedit, a.s., ka qenë fjala "Lexo" (Kuran, El Alek, 1), për të vazhduar më pas me urdhra për të zënë dije dhe për t'u konsultuar me dijetarë (Kuran, En Nahl, 43), me dobi dhe mirësi të dijes (Kuran, El Muxhadele, 11), si dhe me efekt-reflektim të dijes - devotshmëri. Allahu i Madhëruar thotë: "...Po Allahut ia kanë frikën vetëm robërit e Vet dijetarë..." (Fatir, 28).

Se mësuesi duhet respektuar flet edhe fakti se dituria nuk mund të merret ndryshe më mirë sesa me mësuesin pranë. Ai që nuk ka edukatë, nuk do të mund të përfitojë prej mësuesit. Allahu i Madhëruar na ka treguar se edukatën e dijes e kanë përfutur edhe pejgamberët.

Respekti për mësuesin është edhe reflektim i respektit tonë për mësuesin e parë, Muhamedin, a.s., i cili është dërguar mësues për njerëzimin. Kështu e ka përshkruar Allahu i Madhëruar. "Ai është që arabëve të pashkolluar ua dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre, që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë Librin dhe Sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme." (El Xhumuah, 2)

Me moton "Vlera e mësuesit dhe pesha e qiellit nuk maten kurrë", Instituti për Studime Sociale dhe Avancim të Lartë - Hasan Tahsin e shënoi Ditën e Mësuesit duke i vizituar disa nga shkollat dhe kopshtet, siç janë shkollat "Hasan Prishtina" Milloshevi, Medreseja Alaaddin Prishtinë, kopshtet Yllkat dhe Filizat etj. Instituti e shënoi edhe 8 Marsin, Ditën e Gruas, me personelin e këtyre shkollave dhe kopshteve, për çfarë i falënderon për mirëpritjen shembullore.



SHPALLEN NXËNËSIT E DALLUAR NË MEDRESE GJATË VITIT SHKOLLOR 2020/2021

Edhe këtë vit në ambientet e Medresesë u shpallën nxënësit e dalluar në nivel të shkolle dhe klase.

Në paralelen e djemve, "Nxënës i dalluar në nivel shkolle" u shpall Seid ARBANASHI, nga klasa 12/3.

Ndërsa në paralelen e vajzave "Nxënëse e dalluar në nivel shkolle" u shpall Anisa DURGUTI, nga klasa 12/4.

Drejtorja e shkollës dhuroi mirënjohje për nxënësit e nxënëset e dalluara, dhe i shpërbleu me një shpërblim modest material.

Urojmë nxënësit dhe nxënëset tona për sjelljet shembullore dhe angazhimin maksimal në mësimet dhe aktivitete!



TË LEXOJMË MË SHUMË!

10 librat për zakonet që jua propozojmë t'i lexoni:

1. Shtatë zakonet e njerëzve shumë efektivë;
2. Zakonet e vogla: zakone më të vogla, rezultate më të mëdha;
3. Fuqia e zakonit: pse bëjmë atë që bëjmë në jetë dhe biznes;
4. Vozitja: E vërteta e habitshme për atë që na motivon;
5. Mendimi: Psikologjia e re e suksesit;
6. Fuqia e vullnetit: Rizbulimi i forcës më të madhe njerëzore;
7. Instrumenti i vullnetit: Si funksionon vetëkontrolli, pse ka rëndësi dhe çfarë mund të bësh për ta përfituar më shumë;
8. Zakonet e performancës së lartë: Sa të jashtëzakonshëm bëhen njerëzit në atë mënyrë;
9. Rifresko: Ndrysho trurin tënd për të thyer zakone të këqija, për të kapërcyer varësitë, për të pushuar sjelljen vetëshkatërruese;
10. Një gjë: E vërteta çuditërisht e thjeshtë që qëndron pas rezultateve të jashtëzakonshme.

(Redaksia)

20 Libra nga letërsia:

1. "Fausti" – Gëte
2. "Plaku dhe deti" – Ernest Hemingueji
3. "Zoti i fluturave" – Uilliam Golding
4. "Haxhi Murati" – Leon Tolstoi
5. "Princi i vogël" – Antoine de Saint-Exupery
6. "Si ta kurosh një fanatik" – Amos Oz
7. "Idioti" – Fjodor Dostojevski
8. "Zgjedhja e Sofisë" – Uilliam Stajron
9. "Në rrugë" – Nga Xhek Keruak
10. "Të vrasësh zogun përqeshës" – Harpër Li
11. "Getsbi i madh" – Skot Fitzxherald
12. "Alkimisti" – Paolo Koelho
13. "Të drejtat e njeriut" – Tomas Pein
14. "Shartimi" – Luigji Pirandelo
15. "Në egërsinë e natyrës" – Xhon Krakauer
16. "Thertorja Pesë" – Kurt Vonegat
17. "Njerëzit dhe ingranazhet" – Ernesto Sabato
18. "Portreti i Dorian Greit" – Oskar Uajlld
19. "Kumbari" – Mario Puco
20. "Ferma e Kafshëve" – Xhorxh Oruell

(Redaksia)



KURIOZITETE

1. Alfabeti më i gjatë në botë është ai kinez, i cili numëron 72 shkronja, dhe gjithsej 105 simbole, ndërsa ai më i shkurti është alfabeti kamboxhian, me gjithsej 7 shkronja.
2. Në trurin e maceve ka 32 muskuj.
3. Shteti me më së shumti rrugë të asfaltuara është Franca.
4. Gjaku në organizmin e njeriut udhëton shumë shpejt: nga zemra deri te gishtërinjtë e këmbës arrin për 16 sekonda, e deri në tru për 8 sekonda, dhe deri në mushkëri vetëm për 6 sekonda.
5. Albert Anjshtajni nuk kishte folur deri në moshën 9 vjeçare. Mësuesi i tij kishte thënë: "Nuk do të pritet asgjë prej tij." Sot ky gjeni është babai i fizikës.
6. Sytë e foshnjave nuk prodhojnë lot derisa fëmija arrin moshën 3 deri në 6 javë.
7. Pse kemi dy veshë? Veshi, një nga pesë shqisat tona, është edhe organi i dëgjimit dhe i ekuilibrit. Falë faktit që ne kemi dy veshë edhe kemi mundësi ta përcaktojmë drejtimin dhe largësinë e ardhjes së zërit. Nëse do të kishim vetëm një vesh, truri ynë nuk do t'i krahasonte dot zërat me njëri-tjetrin, si dhe ne nuk do të orientoheshim dot se nga na vjen zëri.

Bukurije Haziri, 12/4

DISA KËSHILLA PARA SE TË HYSH NË TESTIMI

1. Zgjidh një vend të qetë, dhe sigurohu që i ke të gjitha pajisjet që të nevojiten!
2. Fillo të mësosh nga shënimet që ke mbajtur kur profesorët kanë shpjeguar!
3. Studio për 45 minuta, pastaj pusho për 15 min!
4. Fillo herët, duke organizuar çdo gjë, kështu që nëse të nevojitet ndihmë, ke kohë që të pyesësh profesorët apo shokët!
5. Organizo shënimet tua në bazë të lëndës, duke dalluar me ngjyra të veçanta gjërat kryesore!
6. Të studiosh në grupe të ndihmon që të jesh më efektiv në mësim.
7. Sigurohu që të pushosh dhe të flesh mjaftueshëm!
8. Ushqehu mirë dhe ushtrohu që të lirohesh nga stresi, dhe sigurohu që je mendërisht i gatshëm për test!
9. Hyr në testim me vetëbesim dhe i relaksuar, dhe mos dysho në vetveten!

(Redaksia)

12 PYETJET MË TË BUKURA TË BËRA NDONJËHERË

1. Çfarë do të bënit nëse do ta dinit që nuk mund të dështonit?
2. Kush mendon se ti je e bukur kur zgjohesh në mëngjes?
3. Si jeni me të vërtetë?
4. Si do të silleshit sikur të ishit më i miri në botë në atë që bëni?
5. A po e gjeni punën tuaj të ëndrrave, apo po e krijoni atë?
6. Nëse do të kishte një zgjidhje për ankthin tuaj, si do të dukej?
7. Kur ishte hera e fundit që keni bërë diçka për herë të parë?
8. Çfarë do të bënte Pejgamberi, a. s?
9. Po sikur të kishte një _____ çfarë mund të _____?
10. Pse ia vlen të dish?
11. Çfarë, ose kush ju ndez?
12. Si i trajtoni ju njerëzit që nuk mund të bëjnë asgjë për ju?

(Redaksia)



Elma Zeneli 12/4



URTINA UKA 11/3



IMRANE ZARIQI



ERINA SALIHU 10/3



RINESA ZENELI 11/3



Meka Bilalli 10/4



Gjyla Rexhepi 10/3



BUKURJE HAZIRI 12/4

40+ iPad Apps to Help You in Your Teaching

www.educationstechnology.com

Classroom Management Apps



Curricula Support Apps



Instructional Tools



Personal Organization Apps





THËNE PËR DITURINË

Dijetarët janë 700 grada mbi besimtarët. Largësia midis tyre është sa rruga e përshkruar për 500 vjet.

Të kërlesh dituri në moshë të re është si të gdhendësh mbi gur.

Mëso një dituri që nuk i bën dëm punës dhe bëj një punë që nuk i bën dëm diturisë.

Sado që të dish, prapë thuaj "nuk di", në jetë mos shit, por bli dituri.

Dituria nuk është ajo që mëson përmendësh, por ajo që të bën dobi.

Fillimi i diturisë është qëllimi. Pastaj vjen dëgjimi, pastaj kuptimi, pastaj qëndrueshmeria dhe në fund përhapja e saj.

Prindi të rrit, shkolla të ndrit.

Nuk ka gjë më të lartë sesa dija. Mbretërit udhëheqin njerëzit, ndërsa dijetarët udhëheqin mbretërit.



**“Dituria e pakët në veprim
është pafundësisht më e vlefshme
se dituria e shumtë që ruhet”** Halil Gibran

